



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.11.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore, për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, me Ministrinë e Drejtësisë, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Avokatin e Popullit, Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, Autoritetin për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naco, Silva Caka dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Toni Gogu – Zëvendësministër i Drejtësisë

Gentian Deva – Këshilltar i Ministres për Çështjet e Brendshme në Ministrinë e Drejtësisë

Mira Zisi – Drejtore e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Drejtësisë

Kozeta Ndoi – Sekretare e Përgjithshme e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

Florian Karaj – Inspektor i Lartë në ILDKPKI

Erinda Ballanca – Avokate e Popullit

Kledia Ngjela – Këshilltare e Avokatit të Popullit

Arben Shkëmbi – Komisioner tek Avokati i Popullit

Ilirian Lole – Shef i Zyrës së Financës së Avokatit të Popullit

Pranvera Strakosha – Komisionere e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil

Arbana Basha – Drejtore e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në KMSHC

Ollga Hodaj – Drejtore e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në KMSHC

Enkelejda Hebibasi – Drejtore e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë në KMSHC

Gentiana Sula – Kryetare e Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Simon Mirakaj – Anëtar i Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Altin Hoxha – Anëtar i Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Marenglen Kasmi – Anëtar i Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Ermira Shtino – Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Vitori Fuq – Përgjegjëse e Sektorit të Financës në Autoritetin për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Bianka Hada – Sekretare e Kryetares së Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Zoica Graçi – Financiere në Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit

Çelo Hoxha – Zëvendësdrejtor i Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit

Ardiana Hala – Drejtoreshë e Procedurave Ligjore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Mirela Rrumbullaku – Drejtoreshë e Shërbimeve Mbështetëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Erion Lili – Specialist i Financës të Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Xhevdet Haxhiu – Drejtor i Drejtorisë së Administratës dhe Financës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë

Arian Parruca – Përgjegjës i Sektorit të Financës në Këshillin e i Lartë të Drejtësisë

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjesi!

Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi plotësohet, kështu që vazhdojmë me rendin e ditës. Në rendin e ditës kemi një çështje: shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”. Në vazhdim do të kemi seancat dëgjimore me institucionet që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve.

Dje ky komision zhvilloi seanca dëgjimore me rreth 11 institucione të shtetit. Sot kemi edhe 8 institucione të tjera.

Relator i këtij projektligji është kolegu Bashkim Fino.

Pa humbur, vazhdojmë me rendin e ditës.

Institucioni i parë për sot në këtë seancë dëgjimore për buxhetin e vitit 2019 është Ministria e Drejtësisë. Nga Ministria e Drejtësisë kemi prezent në komision zotin Toni Gogu, zëvendësministër, zotin Gentian Deva, këshilltar dhe zonjën Mira Zisi, drejtoreshë e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Zoti Gogu, mirë se erdhët në komision!

Ju lutem, shkurtimisht nevojat e institucionit tuaj për buxhetin e vitit 2019 dhe sa nga këto nevoja janë marrë në konsideratë nga Ministria e Financave dhe çfarë mund të ofrojë Komisioni i Ligjeve pas kësaj seanca dëgjimore.

Fjala është për ju.

**Toni Gogu** – I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë,

Vijmë përpara jush sot me shumë kënaqësi. Kënaqësia lidhet me dy momente: së pari, sepse ju si komision keni qenë një nxitës shumë i madh i reformës në drejtësi, secilës sot, përveç paketave ligjore të ndryshme që ju keni miratuar në kohë të ndryshme, sot po i sjellim edhe numra së bashku me Ministrinë e Financave dhe me qeverinë, duke treguar edhe një herë përkushtimin e qeverisë që gjërave që vlerëson mirë t’u vërë numrat e duhur dhe të tregojë rëndësinë e duhur; së dyti, për shkak të paketës që ju po e vazhdoni. Janë një sërë paketash, të cilat i keni në diskutim e

sipër. Kështu që kërkoj bashkëpunimin tuaj për këtë gjë, për shkak se kostot e përfshira edhe në këto paketa do t'i parashtroj më pas.

Ky buxhet, siç ju e dini shumë mirë, vjen si një program buxhetor afatmesëm që konsolidon edhe një herë përparësitë e qeverisë. Për këtë arsye buxheti, që kam kënaqësinë të sjell përpara jush, ka një investim serioz në pagat e magjistratëve dhe në pagat e shpenzimet të të gjitha institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, që është një nga prioritetet e qeverisë. Gjithashtu, në buxhet janë edhe një sërë buxhetesh të tjera, siç është aksesit në drejtësi, ku një pjesë e rëndësishme e paketës ka të bëjë me ndihmën juridike, me jetësimin e saj, si dhe me jetësimin e reformës së drejtësisë penale për të mitur, të cilat më pas mundet edhe t'i diskutojmë një nga një.

Një gur shumë i rëndësishëm në këtë themel të reformës në drejtësi është reformimi i sistemit penitenciar, sistemit ndëshkimor, pra burgjet, siç njihet nga qytetarët. Aty kemi një sfidë shumë të madhe. Pra, ju së shpejti do të diskutoni projektin. Sfida e madhe që kemi është që oficerët tanë të Policisë së Burgjeve duhet të kenë një shpërblim financiar të denjë për detyrën që kryejnë dhe për shërbimin që kryejnë ndaj publikut shqiptar. Ne duhet të adresojmë në fushën e investimeve mbipopullimin e burgjeve, por edhe trajtimin e të dënuarve me dinjitet.

Një pjesë shumë e rëndësishme e paketës dhe e pjesës së buxhetit të programit të drejtësisë është lufta kundër korrupsionit, që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve transparente e në kohë për qytetarët, si dhe me mbështetjen e strukturave përkatëse, të cilat kryejnë këtë punë.

Në përfundim, dua të them se buxheti i drejtësisë tregon edhe një herë se kemi rritje, pra qeveria nuk sjell vetëm fjalë në ligje, por sjell një investim konkret serioz. Rritja e vitit 2012 është 17%, në krahasim me buxhetin e vitit të kaluar. Edhe në vitin 2020 ka një rritje më të lehtë prej 3% për të krijuar pastaj një sfumim, sepse ne duam të tregojmë që në vitin 2019 është pjesa më e madhe e investimeve dhe puna më e madhe e qeverisë në lidhje me jetësimin e reformës në drejtësi.

Dua ta mbyll këtu prezantimin kryesor për t'ua lënë fjalën kolegëve të financave. Kam kënaqësinë që të kem këshilltarin e Ministres për Çështjet e Brendshme dhe drejtoreshën e Menaxhimit Financiar për t'i diskutuar më në detaje elemente të ndryshme, por edhe disa shtesa, të cilat nuk arritën të parashikoheshin, për shkak se janë paketa të cilat ju i keni në diskutim e sipër dhe duhet të gjejmë një zgjidhje për to.

Faleminderit, kryetar

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Gogu!

Kush do t'i parashtrojë kërkesat financiare?

**Mira Zisi** – Kërkesat shtesë që ne kishim parashikuar edhe në fazën e parë, por edhe në fazën e dytë të PBA-së janë për shpenzime personeli, paga dhe sigurime 654 milionë lekë, ndër të cilat 643 milionë lekë janë për stafin policor. Kjo shtesë vjen për gradat, me qëllim unifikimin e gradave të punonjësve të Policisë së Shtetit me punonjësit e Policisë së Burgjeve dhe shtesa për vjetërsi në punë. Pra, stafi policor i Policisë së Burgjeve të trajtohet njësoj me stafin e Policisë së Shtetit. Kjo shifër shkon në 643 milionë, pothuajse në shifra të barabarta për të dy zërat, për gradën dhe për shtesën për vjetërsi në punë. Ndërsa 11 milionë lekë ne i kishim parashikuar për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

Kishim parashikuar rreth 371 milionë lekë për mallra dhe shërbime, ku 21 milionë lekë na duhen për agjencinë e të drejtave, meqenëse Ministria e Drejtësisë është përfaqësuese...

**Toni Gogu** – Është një organizëm ndërkombëtar në BE.

**Mira Zisi** – Në datën 14 nëntor është parashikuar të nënshkruhet marrëveshja midis Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim Asociimit, kështu që menjëherë jemi të detyruar të paguajmë rreth 21 milionë lekë si kontribut për pjesëmarrjen në këtë agjenci, pra është kuotë anëtarësimi.

Për Agjencinë e Trajtimit të Pronave janë rreth 216 milionë lekë për pjesën e kompensimit të pronave.

Për shpenzimet kapitale ne kishim parashikuar rreth 840 milionë lekë për sistemin e burgjeve, ku u morën parasysh 200 milionë lekë për sistemin e sigurisë në burgje, kjo është shifra më e madhe. Rreth 100 milionë lekë për Institutin për Edukimin dhe Rehabilitimin e të Miturve nuk na janë marrë parasysh.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për investime në Institutin për Edukimin dhe Rehabilitimin e të Miturve, pra janë shpenzime kapitale.

Kemi kërkuar 325 milionë lekë financim të huaj, kjo na u mor parasysh për të tre vjetët buxhetorë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ekstra duam për Institutin për Edukimin dhe Rehabilitimin e të Miturve. Kjo është më e rëndësishmja.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit!

A keni gjë tjetër për të shtuar?

**Mira Zisi** – Nuk kemi.

**Ulsi Manja** – Fjalën e ka zoti Fino, më pas do ta marrin fjalën përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, të cilët i lashë t’i prezantoja tani: sekretarja e Përgjithshme, zonja Geraldina Prodani dhe drejtoresha e Buxhetit, zonja Mimoza Dhëmbi.

**Bashkim Fino** – Faleminderit, kryetar!

Falënderoj edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, zëvendësministrin, drejtoreshën dhe këshilltarin!

Pjesa kryesore e diskutimit të projektbuxhetit tonë, si komision përgjegjës, është Ministria e Drejtësisë, pra që është, si të thuash, pjesa e luanit.

Ky projektbuxhet ka një rritje të konsiderueshme. Natyrisht, të gjitha ato që tha drejtoresha këtu mbeten sfida për të ardhmen. Ajo që është e rëndësishme, të cilën duhet ta përmendim fort, të cilën e thamë edhe dje, por do ta përmendim edhe sot, është mbështetja financiare e padiskutuar dhe në mënyrë absolute e të gjithë reformës në drejtësi. Kjo mbështetje për reformën në drejtësi, duke filluar që me pagat e larta që do të marrin gjithë gjyqtarët dhe prokurorët pas vetingut, do të thotë së dëshira dhe vullneti i qeverisë ka qenë i palëkundur. Nga ana tjetër, më lejoni t’ju them se në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë janë shtuar 70 veta që janë pasqyruar në buxhet. Ata janë këtu për shkak të krijimit të Institutit për Edukimin dhe Rehabilitimin e të Miturve, pra 70 veta janë shtuar tashmë në buxhet, por duhet parë mundësia e shpenzimeve.

Një problem tjetër që duhet theksuar është se, në kuadër të rritjes së pagave, edhe Policia e Burgjeve do të ketë një rritje të pagave për vitin 2019, duke filluar nga 1 prilli i vitit tjetër, me rreth 7%. Shuma prej 177 milionë lekësh nuk është në evidencën e Ministrisë së Drejtësisë, por është në shumën e kontigjencës që është në buxhetin e madh që ne do të miratojmë. 177 milionë lekët, sipas Ministrisë së Financave, me 7% rritje, sepse do të ketë një rritje të pagave të tyre nga 1 prilli, do të shkojnë më vonë te Ministria e Drejtësisë. Ndërkohë, ajo është pjesë e kontigjencës së qeverisë, e cila do të ketë rritje për shumë kategori për vitin tjetër. Pra, infermierët, mjekët, policia në përgjithësi dhe diplomatët janë një kategori punonjësish, të cilët ne i kemi pasqyruar në kontigjencën tonë, por nuk i kemi ta ndara te ministrinë e linjës. Kjo do të thotë se, përveç këtij buxheti që ka sot Ministria e Drejtësisë, vitin tjetër do të ketë një buxhet ekstra për rritjen e pagave të Policisë së Burgjeve.

Ajo për të cilën kërkoj një përgjigje edhe nga zëvendësministri apo nga përfaqësues të tjerë të Ministrisë së Drejtësisë janë problemet e investimeve, të cilat janë shumë të rëndësishme,

sidomos në burgje. Sa më shumë fonde të kemi ne dhe sa më shumë t'i japësh Ministrisë së Drejtësisë, jam shumë i bindur që ato alokohen shpejt dhe duhet të investohet më shumë, sidomos në sistemin e burgjeve. Këtu ka investime, të cilat janë realizuar sivjet, me gjëra të vogla që duhet të mbyllet brenda këtij viti, por janë rreth 1 miliard investime për vitin 2019. Problemi është se, në qoftë se ne do të kemi vërtet mundësinë absorbuese të thithjes së këtyre fondeve dhe të bërjes së investimeve për bujë, do të jetë një gjë e mirë dhe mendoj se kjo është pjesa që mund ta ndihmojë më shumë Ministrinë e Drejtësisë.

Gjithsesi është një buxhet i saktë, i drejtë dhe mendoj se me këto shifra që ka këtu dhe me ato që janë në buxhetin e madh për sa i përket Ministrisë së Drejtësisë, por edhe pjesa e kontigjencës, zoti zëvendësministër është në funksion të reformës në drejtësi dhe në funksion të drejtësisë në tërësi.

Mos harroni t'ju them një gjë, nga kjo reformë në drejtësi po mundohen t'i përfitojnë edhe institucione të tjera, që nuk e meritojnë të përfitojnë rritjet e pagave duke thënë se X ka 80% të pagës së gjyqtarit, po gjyqtari bën vetingun, ky që nuk bën vetingun, pse duhet ta marrë këtë 80%-shin?! Të gjithë e kërkojnë rritjen e këtyre pagave. Ndërkohë te Ministria e Drejtësisë kjo gjë është e zgjidhur dhe është e ezauruar. Mendoj se me kontigjencën dhe me shifrat që ka Ministria e Drejtësisë mbushet dhe kryhet aktiviteti i mbështetjes, në mënyrë inkurajuese, por, natyrisht, gjatë vitit 2019 ne jemi këtu për të rregulluar çdo gjë që mund të ndodhë gjatë rrugës. Këtë kam në parim, meqenëse edhe parafolësit e mi ishin në një linjë me projektbuxhetin e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë në qeveri.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Urdhëroni, zonja Prodani!

**Gelardina Prodani** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu sikurse u prezantua nga zëvendësministri, buxheti i Ministrisë së Drejtësisë ka një rritje prej 17,2% krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2018. Ashtu sikurse u deklarua edhe nga zoti Fino, ky është një fond 177 milionë lekë i pashpërndarë, i dedikuar për kontigjencën e rritjes së pagave, për Policinë e Burgjeve, nga të cilët përfitojnë 3 mijë e 559 policë.

Për sa i përket fondit të pronave, ai është kundrejt gjithë *time scheduleve* që kemi dërguar në Strasburg për reformën e pronave dhe akordohet për periudhën afatmesme në vlerën 5 miliardë lekë.



Për sa u përket fondeve për rehabilitimin dhe edukimin e të miturve, Ministria e Drejtësisë ka një rritje të investimeve në vlerën 160 milionë lekë kundrejt vitit të kaluar dhe vlera në total është 1 miliard lekë, prej të cilave 717 milionë lekë janë fond me financim të brendshëm, duke prioritarizuar, pikërisht ato që janë më të rëndësishme dhe kundrejt prioritarizimit që ka për reformën në drejtësi Ministria e Drejtësisë, duhet të prioritarizohet dhe të investojë atje ku i ka prioritetet maksimale.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Bushka!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një pyetje për sa i përket buxhetit në lidhje me zbatimin e ligjit “Për ndihmën juridike”. Ligji “Për ndihmën juridike”, i miratuar vjet dhe që hyri në fuqi në qershor të këtij viti, është një ligj, i cili është shoqëruar me faturë financiare që në momentin e miratimit të tij.

Pyetja ime (sepse duke mos qenë ekonomiste, nuk mund t’i bëj dot analizat ekonomike) ka të bëjë me faktin: a është mbajtur në konsideratë planifikimi i fondeve për buxhetin e vitit 2019? Duke iu referuar faturës financiare, me të cilën është miratuar ligji, dhe duke marrë në konsideratë faktin, sepse mendoj se këtë vit buxheti që ka qenë akorduar për zbatimin e ligjit “Për ndihmë juridike”, nuk është shfrytëzuar i plotë për sa kohë që efektet e zbatimit të ligjit nuk kanë filluar të plotë, e kam fjalën në kuptimin e ngritjes, në mënyrë të plotë, të strukturave përkatëse të ndihmës juridike.

Së dyti, në lidhje me reformën në sistemin penitenciar, dua të përgëzoj pa diskutim qeverinë për rritjen e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve, sepse ne, kuadër të të gjitha reformave, duhet të unifikojmë çështjen e pagave në sektorë të ndryshëm, aq më tepër në sektorin penitenciar, ku kemi standarde që duhet t’i arrijmë edhe për sa i përket veprimtarisë sonë si vend me ato që na kërkohen në kuadër të integritimit në Bashkimin Europian.

Me aq sa jam në dijeni, së shpejti në Kuvend do të kemi shqyrtimin dhe diskutimin e ligjit “Për Policinë e Burgjeve” nëse do të ketë ndryshime apo shtesa, a do të ketë një ligj të ri, është një çështje tjetër, por edhe ai është një ligj, i cili do të shoqërohet me një faturë financiare, ku mendoj se në zërat e buxhetit nuk do të jetë vetëm çështja e rrogave, por edhe detaje të tjera. Në fakt, kjo është një pyetje për ata që janë ekonomistë. A duhet mbajtur kjo në konsideratë për buxhetin që bëhet për vitin 2019, apo është një çështje që do të sistemohet gjatë vitit? Thjesht po jua sjell në

vëmendje, sepse edhe ai do të jetë një ligj me faturë financiare, do të bëhet shumë shpejt, kështu që të rakordojmë, sepse nga këtu do të burojnë të gjitha vendimmarrjet.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bushka!

Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj, zotin Gogu dhe të gjithë stafin e Ministrisë së Drejtësisë!

Kam një pyetje lidhur me zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale të të Miturve, është pjesë e reformës në drejtësi, një nga risitë, por edhe një nga angazhimet që ka Ministria e Drejtësisë. Nëse ju kuptova qartë, atë që më pas me të drejtë edhe kolegu Fino e konfirmoi, ju tashmë keni parashikuar ngritjen e qendrës së parandalimit të kriminalitetit për fëmijët nën moshën 14 vjeç dhe stafin apo stafi është për ndonjë qendër të trajtimit të të miturve të dënuar, sepse dëgjova dy terminologji të ndryshme.

Së pari, nëse është parashikuar ngritja e qendrës dhe stafi, a është parashikuar buxhet për të gjitha aktivitetet mbështetëse të rehabilitimit të fëmijëve nën moshën 14 vjeç?

Së dyti, në kuadër të reformës në drejtësi dhe ligjeve që ne kemi miratuar, pra Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, që do të kalojë në seancë plenare javën që vjen, shumë detyra merr shërbimi i provës. Nga raporti që ne morëm zyrat e shërbimit të provës nuk kanë mjedise, i kanë me qira, a keni parashikuar fonde për ekzekutimin e asaj që quhet shmangia në rastin e Kodit për Drejtësisë Penale të të Miturve dhe ofrimin e shërbimeve të tjera?

Së treti, reforma e pronës, të paktën kjo qeveri ka marrë një angazhim për t’u dhënë fund të gjithë problematikave që ekzistojnë me pronat, qoftë me ALUIZNI-n, me hipotekën e të tjera. Një nga problemat që kemi konstatuar në misionin monitorues të parlamentit është mospërputhja e hartave midis ALUIZNI-t dhe hipotekës, dhe këto kanë impakte në procesin e vetingut, por edhe të punës që duhet të bëjnë për të parandaluar transaksionet dhe grabitjen e pronës. Reforma e pronës (këtë e kam për Ministrinë e Financës) është parashikuar në këtë buxhet, apo qeveria do të ketë ndonjë fond në vijim për të bërë idenë që ka për bashkimin e agjencisë së pronës dhe krijimin e të gjitha databazave që duhet për të hedhur në sistem të gjitha pronat që zotërojnë qytetarët ose pronarët që janë në proces legalizimi për të ditur kush ka, çfarë ka kështu me radhë për të bërë transparencën e të gjithë aseteve që kanë qytetarët shqiptarë?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Urdhëroni, zoti Gogu!

**Toni Gogu** – Faleminderit për pyetjet!

Së pari, te ndihma juridike, patjetër që ne i kemi kryer dhe në qeveri një pjesë e përlllogaritjeve janë aprovuar, por gjithsesi vijmë me disa kërkesa shtesë për ndihmën juridike. Ne kemi marrë parasysh dhe janë pjesë e buxhetit për ngritjen e drejtorisë, me të gjitha shpenzimet përkatëse, por ne planifikojmë dhe do të donim që të ishin dhe 4 qendra, që të funksiononin brenda vitit 2019, në mënyrë që ne të fillonim dhe të pilotonim shërbimet e ndihmës parësore, të cilat kanë një shumë të caktuar. Pra, bëhet fjalë për 12 punonjës shtesë, për 8 qendra dhe diku te 89 milionë lekë fond shtesë për mallrat dhe për shërbimet në mënyrë që të funksionojnë. Pra, kemi sjellë një kërkesë shtesë, në mënyrë që ligjin ta zbatojmë sa më mirë dhe mos ta zbatojmë pjesërisht.

Së dyti, reforma në sistemin penitenciar, patjetër që kemi nevojë për rritjen. Falënderoj zotin Fino, që bëri të gjithë shpjegimin e duhur, por aty ka nevojë për një rritje tjetër në mënyrë që ne të zbatojmë atë paketë që kemi sjellë dhe duhet ta diskutojmë, pra bëhet fjalë për një rritje prej 400 milionësh.

Në fakt, janë dy qendra që Kodi Penal na detyron të ngremë, nuk është vetëm qendra për parandalimin, por është edhe qendra për edukimin, dhe, pak a shumë, është një qendër e hapur. Pra, nuk bëhet fjalë për një institucion të mbyllur, ku ekzekutohen vendimet, jo burg, por është një qendër e hapur, ku sistemet e integruara sigurojnë që të miturit të vazhdojnë shkollën, të vazhdojnë profesionet e kështu me radhë bashkë me komunitetin. Për këtë qendër ne kemi personel, pra është miratuar një personel, por jo për qendrën tjetër. Ndërkohë, për qendrën për parandalimin e krimit, nuk kemi personel, kështu që kemi ardhur me një kërkesë shtesë edhe për këtë.

Për shërbimin e provës kemi parashikuar 165 milionë e 300 mijë lekë, që mendojmë se i përballon nevojat tona, por gjithashtu ka edhe një kërkesë shtesë prej 17 milionë lekësh.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo është vetëm për shërbimin e provës, kurse për pjesën e pronave jemi fokusuar kryesisht te kompensimi financiar i shpronësimeve. Kështu që e kemi marrë përsipër dhe është një faturë e konsiderueshme.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Gogu!

Zoti Braho, ka një pyetje.

**Spartak Braho** – Është e njëjta pyetje që bëri edhe zonja Bushka, e cila lidhet me projektligjin që do të vijë së shpejti “Për Policinë e Burgjeve”. Me aq sa unë di, janë projektuar marrje masash për sigurinë e nivelit të lartë në burgje gjë që, patjetër, do të shoqërohet me zhvillimin e projekteve të mëdha , sepse ne sigurinë në burgje nuk e kemi në nivelin që kërkohet. Konkretisht, keni ndonjë parashikim, apo kërkoni mundësi të tjera? Sot është emergjente një monitorim i mirë i burgjeve dhe pa dyshim kërkon zhvillimin e projekteve të rëndësishme, të posaçme dhe të shtrenjta në kuptimin financiar.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Braho!

Urdhëroni, zoti Gogu!

**Toni Gogu** – Faleminderit, zoti Braho!

E gjithë paketa që ne kemi sjellë për reformimin e sistemit penitenciar, që është një faturë diku te 700 milionë lekë, kryesisht përbëhet nga dy komponentë kryesorë, njëri komponent është modernizimi dhe fuqizimi i stafit policor të burgjeve për shkak se ata kryejnë një pjesë të madhe dhe heqin një pjesë të madhe të rrezikut të lartë, që ekziston atje. Kështu që kjo ka të bëjë me pagat e tyre dhe është diku te gjysma, kurse pjesa ka të bëjë me infrastrukturën dhe ka të bëjë vetëm me investimet që rrisin sigurinë, në pjesën infrastrukturore është diku te 146 milionë lekë. Kështu që kemi sjellë edhe një kërkesë për atë gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, jemi duke folur vetëm me lekë të rinj.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Gogu!

Para se ta mbyll kam edhe unë një pyetje për relatorin dhe për Ministrinë e Financave lidhur me ndihmën juridike. Me sa shikoj për ndihmën juridike janë parashikuar rreth 13 milionë lekë. Ministria e Drejtësisë, a jam i saktë te kjo pjesë? Pra, në ligjin “Për ndihmën juridike” janë parashikuar 13 milionë lekë.

**Mira Zisi** – 73,5 milionë lekë të rinj.

**Ulsi Manja** – Në rregull.

Faleminderit! Nuk kam pyetje.

73,5 milionë lekë të rinj janë për ligjin “Për ndihmën juridike”, pra jemi brenda përcaktimeve që kemi bërë si komision në momentin e miratimit të ligjit, pra fatura financiare e ligjit në momentin e miratimit ka qenë rreth 500 milionë lekë të vjetër ose 50 milionë lekë të rinj.

Kështu që jemi brenda parashikimeve dhe brenda asaj fature financiare që ka ligji. Nuk kam pyetje të tjera.

Faleminderit, Ministrisë së Financave!

**Bashkim Fino** – Në konkluzion dua të them se natyrisht çdo ministri kërkon, asnjëherë nuk është e kënaqur me buxhetin. Me buxhetin jemi të pakënaqur edhe ne si deputet për çdo zonë elektorale, për investime e të tjera. Nuk diskutohet që sa më shumë të ketë, aq më mirë i përdor, por për buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë, dua të them se është një buxhet i ekuilibruar, brenda kërkesave të tyre në funksion të ligjeve që ne kemi miratuar, në funksion të reformës në drejtësi, që kemi bërë. Pyetja e fundit e zotit Braho ishte shumë interesante, por ne nuk mund të parashikojmë paradhënie para se të kalojmë ligjin e burgjeve, boll që më 1 prill do të fillojë një rritje e pagave të gjithë Policisë së Burgjeve që është 177 milionë dhe që përfitojnë mbi 3500 policë burgjesh. Ndërkohë, do të bëhet ligji dhe absolutisht ajo do të ketë faturë financiare dhe pastaj fatura financiare është në momentin që ne e miratojmë e tutje, që do të jetë nga kontigjenca. Përveç kësaj, ky projektbuxhet ka edhe një aneks tjetër, aneksin e kontigjencës së qeverisë, që është në funksion të reformës në drejtësi dhe të gjitha institucioneve të reja që ne kemi ngritur. Mua më vjen mirë, që kolegët tanë bëjnë pyetje dhe interesohemi, sepse kjo është ministria kryesore që kemi si Komision Ligjesh, që duhet të interesohemi, dhe po nuk që kjo e shëndoshë financiarisht, nuk mund të jenë dhe institucionet e pavarura. Kështu që, me të dhënat që ne kemi dhe që na dha Ministria e Financave dhe që i konfirmoi zëvendësministri i Drejtësisë, mendoj që ta kalojmë këtë projektbuxhet dhe në qoftë se ka ndonjë gjë tjetër, ne gjatë vitit jemi të lidhur me Ministrinë e Drejtësisë, sepse këtu të gjithë ligjet nga kjo ministri vijnë dhe ne këtu do të jemi përsëri për të folur.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Besoj se me fjalën e relatorit, zotit Fino e mbyllim seancën dëgjimore për projektbuxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Faleminderit, zoti Gogu, zoti Deva dhe zonja Zisi për prezencën tuaj në komision!

Vazhdojmë me Inspektoratin e Lartë të Deklarimeve dhe Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Interesit.

Të ftuar nga Inspektoratin e Lartë të Deklarimeve dhe Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Interesit kemi zonjën Kozeta Ndoi, sekretare e Përgjithshme dhe zotin Florian Karaj, inspektor i lartë.

Do t'ju lutesha shumë shkurt të na thoshit nevojat e institucionit sa janë marrë në konsideratë nga Ministria e Financave dhe çfarë kërkon nga komisioni, sepse diskutimi i projektbuxhetit është çështje shifrash dhe jo fjalësh.

Urdhëroni!

**Kozeta Ndoi** – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar kolegë,

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Interesit për projektbuxhetin e vitit 2019 i është planifikuar një fond prej 138,7 milionë lekësh, por Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Interesit sot vjen me një kërkesë për fonde shtesë për shpenzime të mirëmbajtjes së shpenzimit të ri të deklarimit *online* të pasurive. Kjo vjen për arsye pse ndryshimet në ligjin nr. 9049 kanë parashikuar si mënyrë të dorëzimit të deklaratave të interesave private mjetet e komunikimit elektronik. Pra, për këtë gjë ILDKPKI-ja ka qenë tërësisht e angazhuar për ngritjen dhe vënien në funksionim të këtij sistemi elektronik të deklarimit *online* të pasurisë së të gjithë zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim. Ne kemi bashkëpunuar dhe negociuar me institucionet ndërkombëtare, si Këshillin e Europës, me USAID-in dhe kemi arritur të realizojmë, me financimet e tyre, disa komponentë të sistemit total dhe janë evidentuar nga partnerët ndërkombëtarë shpenzimet e mirëmbajtjes, të cilat janë të detyrueshme për t'i arritur dhe për t'i vënë në funksion në 3-mujorin e parë të vitit 2019, si dhe marrjen në dorëzim të këtij sistemi. Ne kemi biseduar dhe kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Financave, kërkesa jonë është shumë modeste, pra kërkojmë një shtesë në shpenzime operative në vlerën e 4 milionë lekëve, do të ishte në konsideratë tuaj miratimi.

**Ulsi Manja** – Faleminderit! Zonja Ndoi ishte shumë e saktë dhe shteruese!

Pra, institucioni juaj është i kënaqur me buxhetin e vitit 2019 dhe keni një kërkesë modeste në lidhje me shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjalën e ka zonja Prodani nga Ministria e Financave!

**Gelardina Prodani** - Ministria e Financave e ka ndjekur projektin dhe e mbështet shumë. Ne e kemi qenë të gatshëm për ta mbështetur që në rishikimin e buxhetit të vitit 2018, por ishte

e paqartë nga ana e donatorit, që po e siguronte projektin e sistemit të IT-së. Tani që jemi të qartë, patjetër që do ta mbështesim.

Do t'ju lutesha ta përcillnit këtë kërkesë edhe te Komisioni i Ekonomisë që ne ta ndjekim mbështetjen edhe atje, për ta vendosur në buxhet, pasi ky është një projekt dhuratë nga USAID dhe KE-ja. Ne do ta mbështesim patjetër.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit!

Urdhëroni, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Kur ka dakordësi, si asnjëherë tjetër midis Ministrisë së Financave dhe institucionit përkatës, mua si relator nuk më mbetet gjë tjetër, veçse ta certifikoj dhe të bëj relacionin për t'ju shtuar 4 milionë lekë për shpenzime operative.

Problemi im është sa të gjej dakordësinë me ta. Meqë këta e kanë gjetur, unë jam në rregull. Kështu ta miratojmë edhe këtë që t'i dërgojmë relacionin e komisionit tonë Komisionit të Ekonomisë për t'ju shtuar 4 milionë lekë për shpenzime operative.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit zoti Fino!

Edhe unë e mbështes kërkesën e relatorit së bashku me kolegët e mi.

Besoj se këtu mbarojmë me seancën dëgjimore me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Faleminderit zonja Ndoi dhe zoti Karaj!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ditë të mbarë!

Vazhdojmë me institucionin e Avokatit të Popullit!

Nga ky institucion janë prezente zonja Erinda Ballanca, Avokate e Popullit zonja Kledia Ngjela, këshilltare, zoti Arben Shkëmbi, komisioner dhe zoti Ilirian Lole, shef i Zyrës së Financës.

Faleminderit për prezencën në komision!

Fillojmë seancën dëgjimore në kuadër të shqyrtimit të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Edhe nga institucioni juaj do të donim të dinim në mënyrë të përmbledhur se cilat janë nevojat që ka institucioni juaj dhe sa janë marrë në konsideratë nga Ministria e Financave, si dhe çfarë kërkonte sot në komision, për çfarë mund t'ju mbështesim ne si komision.

Fjala për ju!

**Erinda Ballanca** - Shumë faleminderit!

Edhe unë dua të marr sa më pak kohë, sepse e kuptoj se çështjet për t'u diskutuar janë shumë. Ne kemi bërë disa kërkesa në lidhje me buxhetin tonë. Kërkesa e parë ka qenë për një shtesë prej 2 milionë lekësh në shpenzimet tona operative. Kjo kërkesë është bërë edhe në vitin e kaluar. Ju, si komision e miratuat, por Komisioni i Ekonomisë nuk e miratoi. Ne e kemi risjellë këtë kërkesë dhe për t'ju kujtuar. Kjo kërkesë është në kuadër të faktit se institucioni e ka thuar se të pamundur ta kryejë atë aktivitet që duhet të kryejë, pas përfundimit të projektit danez, i cili mbulonte rreth 70% të aktivitetit për sa i përket promovimit të të drejtave të njeriut. Dua të sjell në vëmendjen tuaj, se që nga viti 2014, ju sigurisht e dini, se institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur edhe detyrën e promovimit të drejtave të njeriut, një mandat, i cili është dhënë në mënyrë të qartë dhe pjesërisht kjo pjesë, këto shpenzime janë mbuluar me fondet e projektit danez në atë kohë.

Me përfundimin e këtij projekti fondet ishin të pamjaftueshme, prandaj ne sollëm një kërkesë, e cila përbënte vetëm 20% të kërkesave të institucionit për vitin e kaluar. Kjo shifër nuk na është miratuar dhe jo vetëm kaq, por na janë ulur edhe shpenzimet kapitale nga 4 milionë lekë (që edhe kjo është një shifër shumë e vogël për institucionin tonë), në 2 milionë lekë pa asnjë lloj justifikimi. Këto janë dy nga elementet, të cilat ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, investimet kapitale, të cilat vjet kanë qenë 4 milionë lekë dhe tani parashikohet të jenë 2 milionë lekë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju kuptoj, por ajo që ne kemi kërkuar ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më falni!

Keni të drejtë se unë nuk jam ekonomiste dhe e thashë gabim këtë gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kërkesa tjetër ka qenë për një shtesë në personel për dy ndihmëskomisionerë të rinj, që prej disa vitesh për dy arsye:

Së pari, për çështjen e promovimit dhe për çështjen që kemi shpjeguar edhe vjet në komision, për çështjen e monitorimit, trajtimit dhe dhënies së opinioneve për ligjet dhe për



çështjen shumë të madhe që vjen sot, atë të integritit. Ne kemi një punë të shtuar, jo të vogël, sidomos në kuadër të integritit evropian, të cilën menduam ta bëjmë me seriozitet dhe me kapacitetet e duhura për ta kryer në mënyrën më të mirë. Prandaj, e kemi kërkuar, por nuk na është miratuar kjo shtesë në personel. Këtë kërkesë për dy ndihmëskomisionerë shtesë unë e kam sjellë në Kuvend edhe vjet, edhe këtë vit. Kjo shtesë ka vlerën rreth 3,4 milionë lekë, në zërin për paga dhe në zërin për kontribute në sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Një kërkesë tjetër, e cila nuk na është miratuar, ndonëse është parashikuar në ligj, me pretendimin se tavanet nga ministria dhe nga vendimi i KM-së janë miratuar të ndryshme, është edhe kërkesa për fondin shtesë të pagave për Avokatin e Popullit dhe për komisionerët. Kjo kërkesë është në përputhje dhe në parashikim të ligjit, i cili...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Të gjitha kamerat të dalin në fund!

2 minuta pushim!

I lutem Zyrës së Medieve të Kuvendit, t’i vendosë kamerat në fund!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

I kërkoj ndjesë Avokates së Popullit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Rifillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve!

I kërkoj ndjesë Avokates së Popullit për këtë ndërprerje!

Zonja Ballanca,

Mund të vazhdoni me prezantimin e projektbuxhetin e institucionit tuaj për vitin 2019!

Më pas e ka fjalën kolegu Fino dhe pas tij, përfaqësuesja e Ministrisë së Financave!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mediet janë të lira të hyjnë aty ku e kanë vendin, por jo këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Le të hyjnë dhe të vendosen atje ku kanë vendin!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush dëshiron, le të hyjë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino, a mund të vazhdojmë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mediet nuk dëshirojnë të futen në komision, se u mërzitën për shkak të këtij qëndrimi...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, zoti Fino!

Me gjithë respektin që kemi për medien e lirë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ato kanë pasqyruar në mënyrë shumë transparente punën e këtij komisioni, por në momentin që nuk kryhet misioni që duhet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Natyrisht, ky është komision pune.

Zonja avokate, mund të vazhdoni!

**Erinda Ballanca** – Kërkesa tjetër që kemi paraqitur në Ministrinë e Financave, është një kërkesë, e cila vjen në zbatim të parashikimeve të Kushtetutës së RSH-së dhe të ligjit funksional të Avokatit të Popullit në bazë të të cilit paga e Avokatit të Popullit është e barabartë me pagën e kryetarit të Gjykatës së Lartë. Duke qenë se në janar të këtij viti paga e kryetarit të Gjykatës së Lartë do të pësojë ndryshim, ne kemi kërkuar që ky ndryshim të reflektohet edhe për sa i përket pagës së Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, pagat e 5 komisionerëve janë sa 2/3 e pagës së Avokatit të Popullit. Kërkesa që ne kemi paraqitur në buxhet për 5,5 milionë lekë përfshin shpenzimet e mëtejshme për shtesat do të duhen për efekt të këtij parashikimi ligjor për këta 6 persona. Dua të theksoj se çështja se me cilin ligj do të trajtohet paga e Avokatit të Popullit dhe struktura e institucionit të tij, është trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila që në vitin 2007 ka përcaktuar qartësisht se dispozitat e ligjit për hierarkinë e pagave kanë qenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe, se për sa u përket institucioneve të pavarura kushtetuese, konkretisht, institucionit të Avokatit të Popullit është qartësisht ligji i tyre funksional dhe Kushtetuta, të cilat prevalojnë nga ligjet e tjera. Në këto kushte ne mendojmë se është i padrejtë dhe i pambështetur pretendimi i MF-së, që ky shpenzim i ri, që ne kërkojmë të fusim në buxhet për pagat, është një shifër, e cila është mbi tavanet e miratuara dhe për këtë arsye, nuk na e miraton.

Në përgjithësi kërkesat tona buxhetore, siç e thashë janë:

5,5 milionë lekë për pagat; 2,3 milionë për 2 ndihmëskomisionerë të rinj që kemi kërkuar dhe kërkojmë të mos na ulen shpenzimet kapitale, pasi edhe në këtë masë që janë, janë relativisht të vogla për të mbështetur aktivitetin tonë. Edhe ndërtesa është e amortizuar, nuk është e re.

Gjithashtu, kërkojmë edhe 2 milionë lekë shtesë për zërin 602.

Këto janë kërkesat tona në total.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit zonja avokate!

Fjalën e ka përfaqësuesja e Ministrisë së Financave!

**Gelardina Prodani** - Për sa u takon detyrimeve ligjore, që rrjedhin nga reforma në drejtësi dhe për sa i takon shtesës që merr në pagë Avokatja e Popullit, ajo është e ruajtur në fondin e kontingjencës, që ka për këtë qëllim Ministria e Financave, kështu që do t'i shtohet më vonë, nuk do të jetë pjesë e buxhetit të institucionit të Avokatit të Popullit në këtë moment. Ajo është në fondin e kontingjencës.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Faleminderit, kryetar!

Falënderoj Avokaten e Popullit për ekspozenë! Ndonjëherë puna të bën të jesh financier, edhe kur nuk je financier. Problemet i ngrite me dinjitet dhe normalisht, pa diskutim, do të mbrosh institucionin tënd.

Unë mendoj kështu, kryetar. Në fakt, vjet u kemi dhënë 2 milionë lekë shpenzime për projektin danez. Kemi qenë korrektë kur kemi thënë se 2 milionë janë dhe nuk na kushton asgjë që ai projekt të vazhdojë, meqë është nisur. Unë tani po e dëgjoj që Komisioni i Ekonomisë kur e ka votuar projektbuxhetin nen për nen në vitin e kaluar, nuk e ka miratuar. Siç duket nuk kam qenë i vëmendshëm.

Unë mendoj që ky 2-milionësh duhet vënë dhe duhet të këmbëngulim të gjithë si komision që projekti danez që ka nisur dhe ka qenë i suksesshëm dhe disa zyra që janë në disa bashki të Shqipërisë, për mendimin tim duhet të ekzistojnë dhe duhet të ecin përpara.

E dyta, për sa i përket shtesës për 2 ndihmëskomisionerë të rinj, unë jam pak skeptik dhe nuk jam shumë dakord ta miratojmë këtë. Po ta shikosh strukturën e Avokatit të Popullit ka mundësi për rregullime brenda për brenda.

Çështja e tretë dhe e katërt për investimet, ju thoni se investimet kanë qenë 4 milionë lekë dhe parashikohet të jenë 2 milionë. Në fund të fundit, nuk ka ndonjë trend, që investimet kur janë në një nivel të caktuar në një moment të caktuar, të vijojnë po ashtu. Për shembull, dje komisioneri Dervishi kishte marrë në vitin 2016 mbi 14 milionë lekë, sepse bëri të gjithë godinën

e institucionit. Tani i kemi dhënë vetëm 3 milionë lekë, sepse nuk ka nevojë t'i japim aq shumë. Domethënë, ka raste kur ka lëvizje.

Problemi është që ju duhet t'i argumentoni në qoftë se ju duhen për restaurimin e godinës që të kërkonti më shumë, por më falni që po jua them, se meqenëse keni pasur 4 milionë në këtë vit, nuk mund të keni përsëri 4 milionë lekë në vitin pasues. Mund të keni edhe 1 milion lekë për investime vitin që vjen dhe mund të kesh 5 milionë lekë, mbas 2 vjetësh. Investimet janë të rëndësishme. Parë nga kjo pikëpamje, unë mendoj se, nëse keni ndonjë dakordësi me Ministrinë e Financave dhe ndonjë projekt për të cilin ju mendoni se nga 2 milionë lekë ju duhen 4 milionë lekë për të bërë zyrat apo për godinën, nuk është ndonjë problem për Ministrinë e Financave t'ju shtojë edhe 1-2 milionë, por nuk mund të themi që meqë e kishim 4 milionë lekë zërin e investimeve, e duam përsëri 4 milionë lekë. Mund të doni edhe 5 milionë lekë, por mund të doni edhe 2 milionë lekë. Prandaj, shikojeni me shafen e Financave që të rakordoni me Ministrinë e Financave. Pra, e hoqëm edhe punën e investimeve.

Hapet një diskutim i madh për pagat. Në fakt, unë jam kundër në koncept, nuk është se nuk e respektoj vendimin e Gjykatës Kushtetuese apo ndryshimin e pagave që kemi bërë tani. Qeveria ka reflektuar, ka një fond kontingjente, që nuk e ka të reflektuar këtë gjë në institucionet e pavarura, ndaj ti nuk e shikon këtë te buxheti i institucionit tënd, por kjo është te fondi i kontingjencës. Këtë nuk e ka as ZBGJ-ja, por është te fondi i kontingjencës.

Këtë tabelë që jua tregova gjatë pushimit që dha kryetari, e tregova për të ilustruar se sa do të rriten pagat mesatare të të gjithë gjyqtarëve dhe të prokurorëve pas vetingut. Kjo është një shumë e konsiderueshme dhe këto para do të jepen që nga 1 janari.

Unë jam kundër vendimit të gjykatës edhe për një gjë tjetër ta them hapur, se unë do të dal edhe në publik e do të bëje dhe kërkesë individuale. S'mundet dot Gjykata Kushtetues të thotë se më 1 janar do t'i marrin pagat të gjithë gjyqtarët pa dallim, edhe ai që është i lagur, edhe ai që është i palagur. Dale pak. Në qoftë se ne nisim nju proces vetingu, ai që del i pastër ta marrë rrogën të pastër, ta marrë rrogën e madhe. Ai që s'e ka bërë ende vetingun, pse duhet ta marrë pagën të lartë që nga 1 janari? Le ta marrë pasi të mbarojë vetingun, të marrë këtë pagë që ka.

Kjo është një çështje...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mirë, pra, këtë po them. Kjo është një çështje që duhet diskutuar.

Sa i përket pavarësisë, më lejoni t'ju them një gjë. Ju jeni juriste, jeni edhe Avokate e Popullit, ndaj më ndihmoni, ndaj më ndihmoni. Madje, do të kërkoja ndihmën tënde, nëse do të ndërmarr një nismë ligjore si qytetar, si deputet dhe si ish-Kryeministër, për Gjykatën Kushtetuese.

Në Kushtetutë thuhet: “Kryeministri i Shqipërisë paraqet buxhetin e Shtetit.” Buxheti i shtetit paraqitet nga Kryeministri. Buxheti i shtetit nuk paraqitet nga asnjë institucion tjetër. E thotë Kushtetuta. Gjykata Kushtetuese nuk mund të thotë: unë do ta vendos vetë rrogën time, sepse jam institucion i pavarur.

Nuk mund ta thotë këtë, ngaqë ka konflikt interesi. Se mblidhen aty dhjetë gjyqtarë dhe thonë: ne do ta vendosim rrogën 5 milionë.

Hallall ta kenë, por ama s'mund ta thonë, sepse është konflikt interesi. Këtë gjë e bën Kushtetuta. Kushtetuta thotë se është Kryeministri ai që e paraqet buxhetin në Kuvend, nuk e paraqet Gjykata Kushtetuese, sepse i bie se edhe ne, si Kuvend, që jemi republikë parlamentare, niveli më i lartë, të paraqisim buxhetin tonë, buxhetin e Kuvendit, ta paraqisim jashtë buxhetit që sjell qeveria. Pra, ti thoshim qeverisë: ti paraqit pak gjitha ministrinë përkatëse, të gjitha institucionet, ndërsa buxhetin tim, atë të Kuvendit, do ta paraqesim vetë si Kuvend. Kemi një byro të financave këtu, dhe mund ta paraqisim vetë. Kështu do t'i vinim rrogat sa të donim, 1, 2, 3, 4, por disiplina financiare është më e rëndësishme se çdo disiplinë tjetër. Duhet ta kuptojmë këtë gjë.

Pavarësisht se e hodha poshtë, unë e kam lexuar me kujdes materialin tënd, e kam lexuar me shumë kujdes, madje edhe e kam nënvizuar, po kur ka një ligj për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura, ai duhet të respektohet nga të gjithë, pavarësisht se mund të mos më vijë mirë mua, ty apo anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Në realitet, çfarë ka ndodhur? Në realitet, ka ndodhur që ne miratojmë ligje organike, ligjin tënd organik, për shembull, ligjin organik të pushtetit vendor, ligjin organik të gjykatave. Po çfarë është ligji organik? Ligji organik rregullon mënyrën e funksionimit të institucionit. Ligji organik nuk është që të vendosim ne se sa do të jenë pagat e drejtuesve të institucioneve. Absolutisht jo. Duhet të ketë një kod të pagave, gjë të cilën do ta bëjë qeveria. Duhet ta bëjë dhe ta sjellë në parlament. Le ta bëjë edhe me tre të pestat po të dojë, që të mos ketë mundësi lëvizjeje nga maxhoranca e ndryshme. Pra, të bëjë një kod, dhe mbi atë kod të shohë se sa ka mundësi ta rrisë rrogën. Absolutisht le ta rrisë.

E fundit, dhe dua të më kuptosh drejt, zonja Avokate e Popullit, sepse ti merresh me hallet e popullit, por edhe ky hall i popullit është.

Neni 12: “Paga e Presidentit të Republikës është 257 mijë lekë, dhe gjatë vitit rritet sipas vendimeve të...”

Pra, pse e përcakton projektbuxheti pagën e \_Presidentit? E përcakton si pagën më të lartë në hierarkinë e pagave. Kur paraqet pagat, Ministria e Financave nuk ka të drejtë t’i japë dikujt tjetër mbi këtë pagë.

Çfarë po na ndodh sot në praktikë, me këtë që kemi bërë? Sot, në praktikë, na ndodh që shumë gjyqtarë, edhe gjyqtari më i thjeshtë, gjyqtari në Gjirokastrë, në Korçë, në Tropojë, në Tiranë, do të marrë një pagë prej rreth 3 milionë lekësh të vjetra. Pra, më shumë se sa Presidenti i Republikës, i cili e ka 257 mijë lekë.

Çfarë do të na ndodhë me këtë që kërkoni ju? E unë jam kundër që komisionerët këtu, po të marrin 80 % të rrogës tënde. Kjo do të thotë se komisionerët e tu, katër a pesë, sa janë, të marrin më shumë se Presidenti i Republikës. Po mirë, po pyes unë: kryetari i shtetit, me gjithë atë angazhim në raport me Kushtetutën, me punët, etj, është i barazvlefshëm me një komisioner të Avokatit të Popullit? Nuk është i barazvlefshëm as me mua, më fal që po ta them, por jam më i zoti se komisioneri yt, sepse kam tërë jetën që merrem me politikë dhe jam parlamentar prej njëzet vjetësh.

Tani unë njëzet vjet, njëzet e pesë vjet deputet, e të marr 1, 8 milionë lekë të vjetra, ndërsa komisioneri yt të marrë më shumë se unë e Presidenti, kjo për shkak se Gjykata Kushtetuese, që sipas meje ka shkelur ligjin dhe është në konflikt interesi, ka thënë se dua ta bëj rrogën siç dua vetë. Në momentin kur e shfuqizon atë që thua ti, se e kam lexuar me kujdes materialin tënd, do të thotë se do ta marrë rrogën sa 80 % e rrogës tënde? Mua më duket absurde kjo.

Natyrisht, me letra ti je në rregull. natyrisht, me këto letra Ministria e Financave duhet të japë zgjidhje dhe të ta japë pagën tënde, se nuk ta fal njeri.

Mos e merr ashtu. Nuk është çështje personale. Nuk e kam për pagën tënde, por e kam për të gjitha institucionet. Mos e merr si diçka personale. Sepse po flas edhe për pagën time, në fund të fundit. Ama, ne duhet të japim një zgjidhje, një zgjidhje për ekuilibër. Po cili është ekuilibri? Kam një propozim unë për Ministrinë e Financave: ta rrisë paga e Presidentit, që ajo të jetë diçka më e lartë se paga e komisionerit tënd, dhe komisioneri ta marrë pagën aq sa i takon. Ta rrisë edhe pagën e deputetit, sepse deputeti s’mund të marrë pagë më të ulët se komisioneri yt. Edhe ti e kupton se deputeti nuk mund të vlerësohet më pak se një komisioner.

Kjo është një çështje që mua, personalisht, si relator, m'i ka vrarë sytë që herën e parë kur jam njohur me këtë buxhet, kur e kam parë e diskutuar. Në fakt, ne kemi bërë disa gabime, por gabime në vite, se nuk po flas thjesht si maxhorancë. Pra, kemi bërë ca gabime nëpër vite, duke hyrë në ligjet organike e duke vënë edhe pagat. Jo, ligji organik është për organet që krijohen, për funksionimin e tyre e të tjera. Se ja, unë kam bërë ligjin organik të pushtetit vendor, po ta them dhe për shkak të njohjes që kemi bashkë, me të cilin edhe ti ke punë. Kur kam bërë ligjin organik të pushtetit vendor, është miratuar me tri të pestat në parlament, nuk jam marrë me vendosjen e pagave të kryetarëve të bashkive. Kam përshkruar funksionet, detyrat që kanë kryetarët e bashkive, këshillat bashkiakë, si zgjidhen, si nuk zgjidhen.

Unë e kisha shumë të thjeshtë, zonja Avokate e Popullit, që në atë ligj, të votuar me tri të pestat, PS dhe PD, sepse pushteti lokal është i të gjithëve, të vendosja aty që një kryetar bashkie të merrte 5 milionë. Jo.

E dini se ka raste në Europë, në Austri, Poloni, ku kryetarët e bashkive kanë marrë pagë më të madhe se Kryeministri, dhe janë shkarkuar? Pse? Sepse e kanë pasur në ligj, që ta vendoste vetë këshilli bashkiak. Mund ta vendosë këshilli bashkiak rrogën e kryetarit të bashkisë, dhe mund ta vendosë 10 milionë. Pse, a do ta lejojmë ne një gjë të tillë?

Pra, kur bëmë ligjin organik të pushtetit vendor, e bëmë për kompetencat dhe detyrat e tyre funksionale. Nuk jemi futur te pagat. Është një institucion tjetër që merret me pagat.

Edhe këtë që kemi bërë me të gjitha institucionet, që jemi futur paksa te pagat, jemi futur padrejtësisht. Për mua është diçka që është bërë pa të drejtë e mbase duhet rregulluar, e duhet rregulluar tani, në kuadrin e këtij vetingu, në kuadrin e kësaj reforme në drejtësi. Secili të marrë hakun e tij, të marrë një rrogë të konsiderueshme.

E këtu, zonja Avokate e Popullit, nuk është fjala për një Avokate të Popullit, për një President, për një guvernator, sepse janë nga një dhe s'është se mua si financier, kjo më krijon problem të madh lekësh. Mua më krijohet problem i madh lekësh kur bëhet fjalë për 150 deputetë, sepse janë 150 rroga. Më krijojnë problem të madh lekësh 61 kryetarë bashkie e kështu me radhë.

Prandaj, them se kjo çështje e do një rregullim.

Tërë këtë arsytim e bëra që ju, Avokate, të më ndihmonit, meqenëse jeni juriste. Gjithsesi, përgjigjen e dha sekretarja e Ministrisë së Financave, që në fondin e kontigjencës janë këto fonde, ndaj nuk mendohet se do të shkelet ligji për ju, për të mos marrë pagat.

Si konkluzion, unë them që ne të çojmë një relacion te Komisioni i Ekonomisë, ku 2 milionë shpenzime operative, sidomos projektin danez, ne do ti vëmë dhe do të këmbëngulim që të kalojnë, kjo nuk diskutohet. Për fondin e shtesës së pagave, që përmendi Avokatja e Popullit, është gjetur zgjidhje nga sekretarja e Ministrisë, në fondin e kontigjencës. Për sa u përket investimeve, le t'u japim kohë deri kur ta kemi shqyrtimin nen për nen. Drejtoresha e Avokates së Popullit le të rakordojë me Ministrinë e Financave, nëse 2-milionëshi që gjendet në ligj është i pranueshëm. Në qoftë se ka nevojë për ndonjë shtesë tjetër, mund të rakordojmë, se nuk na prish punë po të shtojmë një milion apo dy milionë. Me këto dy kërkesa, që unë mendoj t'ia paraqesim Komisionit të Ekonomisë, dhe me këtë diskutim, le të themi akademik që bëjmë, por që na vlen të gjithëve, mendoj se jemi në rregull me projektbuxhetin e Avokatit të Popullit. Nuk besoj se ka ndonjë diferencë të madhe, apo jo?

Ju faleminderit!

**Ulsi Manja** – Po, zonja avokate.

**Erinda Ballanca** – Ju falënderoj shumë për gjithë paraqitjen dhe parashtresën. Desha vetëm të theksoja një element, në kuadër edhe të asaj që ju keni trajtuar. Çështja e pagës së Avokatit të Popullit nuk është vetëm në ligjin funksional, por edhe në Kushtetutë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, dua t'ju them se është edhe në Kushtetutë. Është i vetmi institucion, për shkak të rëndësisë, që barazvlefshmërinë e statusit të Avokatit të Popullit e ka të përcaktuar edhe në Kushtetutë. Prandaj ka qenë ai vendimi i gjykatës. Në fakt, ai vendim i Gjykatës Kushtetuese nuk ka pranuar të gjitha kërkesat që kanë paraqitur institucione, por vetëm disa, duke qene se Kushtetuta e ka përcaktuar qartësisht se në çfarë grade do të ishte roli dhe paga e Avokatit të Popullit. Prandaj, them se në rastin konkret është edhe çështje kushtetuese, për sa i përket rëndësisë dhe vlerës.

Do të doja shumë që në lidhje me pyetjen që bëhet tërë kohën nëpër rrjetet sociale e nëpër medie, sa herë që ka ndonjë padrejtësi, kur thuhet: “ku është Avokati i Popullit”, të kishte një përgjigje dhe ne të gjendeshim gjithmonë aty. Prandaj jam këtu, duke kërkuar për stafe pak më të shtuara, edhe për çështjen e personave, sa u përket raportimeve, edhe në lidhje me çështjet që ju mi keni lënë si detyra për të bërë raportime më të qenësishme, më të mira. Prandaj i kam këto kërkesa, sepse vërtetë na duhen kapacitete për të arritur ato që duam të arrijmë: një qeverisje dhe një administrim më i mirë.



Ju falënderoj!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja avokate!

Besoj se u mirëkuptuam edhe në lidhje me kërkesat që ka institucioni juaj. Me mbështetjen edhe nga ana e kolegëve të tjerë të komisionit, besoj se këto kërkesa të Avokatit të Popullit do të bëhen pjesë e relacionit, që ne do t'i përcjellim Komisionit të Ekonomisë. Do të bëjmë përpjekje që këto kërkesa të merren në konsideratë edhe në komisionin përgjegjës.

Shumë faleminderit për prezencën, zonja avokate!

Ditë të mbarë!

Ju lutem, vazhdojmë me institucionin tjetër në radhë: Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

Nga Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil kanë konfirmuar pjesëmarrjen zonja Pranvera Strakosha, Komisionere; zonja Arbana Basha, Drejtore e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit; zonja Ollga Hodaj, Drejtore e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse; zonja Enkelejda Hebibasi, Drejtore e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Ju lutem, zini vend!

Zonja Strakosha, mirë se erdhët në komision!

Do t'ju lutesha që, shumë shkurt, telegrafisht, të an thoshit se cilat kanë qenë nevojat që i keni paraqitur Ministrisë së Financave, në shifra e në zëra, sa janë marrë në konsideratë nga Ministria e Financave, dhe çfarë mund të bëjmë ne si Komisioni i Ligjeve, në lidhje me akomodimin e kërkesave tuaja si institucion.

**Pranvera Strakosha** – Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë,

Shkurtimisht, po ju them se gjatë këtyre viteve të veprimtarisë së Komisionerit ka lindur nevoja për disa ndryshime në strukturë, gjë që u konstatua edhe nga ky komisioni i nderuar në momentin që Komisioneri raportoi në lidhje me veprimtarinë vjetore të 2017-ës. Për këtë arsye, ne i kemi paraqitur kërkesat tona edhe në Ministrinë e Financave, por ato nuk janë pasqyruar, pra nuk janë marrë parasysh.

Kemi kërkuar shtesë organike me katër persona, katër inspektorë, pasi veprimtaria e komisionerit është rritur jashtëzakonisht, pa dashur të zgjatet, qoftë edhe në inspektime mbikëqyrjeje në shqyrtimin e hetimit administrativ dhe në ndjekje zbatimit të vendimeve, që është edhe një detyrë e Kuvendit, në kuadrin e strukturës për monitorimin e institucioneve.

Impakti që do të kishte në buxhet ndryshimi i strukturës, është 5200 mijë lekë. Në total, buxheti i planifikuar për 601 paga dhe kontribute sigurime e tatime, është 40 350. Kemi kërkuar këtë shtesë, dhe shkon 45. 550.

Ndërkohë, te mallrat dhe shërbimet e tjera, për tre vitet në vazhdim, sepse buxheti është parashikuar 19 2021, kemi kërkuar një shtesë për vitin zgjedhor 2019 dhe 2021. Duke qene se Komisioneri, për shkak të ligjit, përfshihet detyrimisht në monitorimin e sjelljes së Administratës Shtetërore gjatë periudhës zgjedhore, ne kemi inspektuar pothuajse të gjitha institucionet që përfshihen në shërbimin civil, me inspektorat tanë me shërbimet direkte, dhe kjo shtesë dhe ky impakt ka të bëjë me dietat për shërbimet brenda vendit. Kjo nuk është marrë parasysh. Kemi kërkuar 7000 mijë lekë. Nga këto, 2000 impaktohen nga shtesat në organikë, ndërsa 5000 janë vetëm për vitin 2019 dhe vitin 2021, si vite zgjedhore.

Ndërkohë, vitin e kaluar ne kemi pasur zërin 231: “Shpenzime për investime”, në shumën 4000 mijë lekë, me të cilën qe parashikuar blerja e një automjeti. Komisioneri funksionon vetëm me një automjet, me të cilin kryen të gjitha shërbimet. Kryesisht përdorim edhe transportin publik, por nëse kemi shërbime urgjente, që kapet një aks i caktuar, brenda ditës shkojnë disa bashki, dhe lind nevoja të shkojnë me automjetin e institucionit. Vjet Ministria e Financave na e bllokoi. Pra, edhe pse ishte e miratuar në buxhet, në muajin korrik na e bllokoi dhe nuk na lejoi ta merrim automjetin. Ne e kemi kërkuar përsëri këtë vit, nëse do ta shikoni të arsyeshme. Në qoftë se ju mendoni se nuk ka hapësira buxhetore për t’u miratuar, ne nuk ngulim këmbë, sepse ju i shikoni çështjet më gjerë për sa i përket impaktit që do të shkaktojnë këto shtesa në buxhetin total.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Strakosha!

Ç’mendim ka Ministria e Financave lidhur me kërkesat e Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil?

**Gelardina Prodani** – Ministria e Financave e ka shprehur mendimin e vet nëpërmjet projektbuxhetit që ka ardhur. Nuk ka asgjë për të shtuar.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Faleminderit, kryetar!

Mbështetur tek ato që dëgjova nga Komisionerja, unë mendoj se ka një të drejtë logjike sa i përket mbikëqyrjes që do të bëjë me rastin e zgjedhjeve të vitit që vjen apo edhe të vitit 2021.

Në këtë kontekst, mendoj se shpenzimet operative duhen rritur. Duhet rritur, sepse ata do të jenë në lëvizje për të bërë kontroll. Kësisoj, do të doja mirëkuptimin e Ministrisë së Financave, por edhe tuajin, që ne t'i paraqesim Komisionit të Ekonomisë një rritje të shpenzimeve prej 4 milionësh për zgjedhjet, duke e specifikuar që janë për zgjedhjet. Plus kësaj, meqë e shikoj që ka një rënie, edhe 2 milionë shpenzime operative për institucionin në tërësi.

Besoj se me këto dy shifra nuk ka nevojë për investime të tjera. Jam pak skeptik në lidhje me rritjen e numrit të punonjësve, sepse këtu kemi tabelën që 88 mijë janë në të gjithë Shqipërinë, dhe e kemi pak të cinguar për shkak të reformës në drejtësi dhe të rritjes që po bëjmë tani për reformën në drejtësi.

Besoj se e dje e dëgjuat, që prokuroria ka kërkuar 197 vetë, dhe si të thuash, në të gjitha portalet janë tallur me mua, që u thashë: po pse, nga e para po e bëjmë këtë institucion? Në fund i miratuam 30 OBGJ dhe 30 komisionerë, që duhej t'i merrte, nga 200 që kërkoi. T'i thuash Prokurorisë së Përgjithshme se kaq mundësi kam të shtoj.... Një institucion si ju pak po kërkon, nuk është se po kërkonin ndonjë gjë të madhe. Më duket pak e tepër ta shtojmë këtë vit. Mund ta kemi parasysh për vitin tjetër. Kjo do të thotë që, nëse gjejmë mirëkuptim me Ministrinë e Financave, që të rrisim 4 milionë shpenzimet operative për sa u përket monitorimit, dhe dy milionë të tjera për shpenzime operative, besoj se mund të kullandriseni mirë për vitin që vjen, siç themi andej nga Jugu.

Sekretarja e Përgjithshme ta vërë dorën në zemër e të thotë një herë: “jam dakord me Bashkimin”, sepse nuk ke thënë kurrë.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zoti Fino!

Ministria e Financave.

**Gelardina Prodani**– Në fakt, ju shprehni mendimet tuaja, kundrejt raportit që do të dërgoni në Komisionin e Ekonomisë. Pastaj vendimmarrja i takon Komisionit të Ekonomisë dhe ministrit të Financave, në rakordim.

**Bashkim Fino** – Po ju mund ta thoni si fjalë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Mund ta thoni si fjalë: që jeni dakord me sugjerimin e bërë nga kolegu Fino.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit zoti Fino!

Shumë faleminderit, zonja Prodani!

Zonja Strakosha, diçka të fundit.

**Pranvera Strakosha** – Faleminderit! Jam shumë dakord. Ju thashë edhe një herë, që thjesht i bëmë këto kërkesa, por duke ditur vështirësitë e buxhetit, realisht jemi shumë dakord me çdo vendimmarrje tuajën.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit!

Edhe ky sugjerim i kolegut Fino do të bëhet pjesë e relacionit për komisionin përgjegjës. Edhe ne bashkohemi me kolegun tonë Fino, lidhur me këto që tha për institucionin tuaj.

Vazhdojmë me institucionin tjetër: Autoriteti Për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

Ka konfirmuar pjesëmarrjen zonja Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit.

Janë disa persona nga stafi kryetares së Autoritetit, por, meqenëse kemi prezente kryetaren e Autoritetit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Sula, mirë se erdhët në komision!

Do t'ju lutesha që, shumë shkurt, të na thoshit se cilat kanë qenë nevojat e institucionit tuaj në lidhje me buxhetin e vitit 2019, sa janë marrë ato në konsideratë nga Ministria e Financave, cila është mundësia e ndihmës apo e akomodimit të ndonjë kërkesë, që mund të bëjë edhe komisioni ynë, si komision përgjegjës, lidhur me Autoritetin.

Fjala është për ju.

**Gentiana Sula** – Ju falënderoj, zoti kryetar!

Anëtarë të nderuar të komisionit,

Unë do të flas për këtë institucion, i cili ka një natyrë pak a shumë të ndryshme nga çfarë dëgjuam deri tani. bëhet fjalë për një institucion të ri, i cili është në vitin e dytë të funksionimit të tij.

E them me modesti, që institucioni ka treguar veten deri tani, që ka pasur një impakt të rëndësishëm publik për sa i përket rishqyrtimit të historisë, edukimit qytetar, të drejtën për informimin e publikut, si dhe verifikimit të figurave të larta – kandidatë për pozicione të caktuara në strukturat e qeverisjes.

Dy janë problemet kryesore, të cilat do të doja t'i ndaja me ju. I pari është plotësimi i organikës. Pra, në dallim nga institucionet e tjera që kërkojnë shtesë organike, ne kërkojmë plotësim organike.

Sekretariati ynë është në 40 % të masës që është miratuar në parlament. Unë kam me vete këtu organikën, zoti relator dhe ju kolegë të Ministrisë së Financave. Me të kuqe keni shënuar pjesën që nuk është plotësuar. Do ta tregoj rast pas rasti se ku i kemi problemet kryesore.

Ju e dini se, së pari, ne jemi një arkiv i integruar, drejtim në të cilin po ecim me shpejtësi, por duhet kuptuar se në bazë të ligjeve të shtetit, arkivi kërkon marrjen në dorëzim fletë për fletë. Ky është mision titanik, sepse arkivi ka qenë i papërpunuar dhe i painventarizuar. Ky është një detyrim ligjor, të cilit nuk mund t'i shmangemi dot. Nga dhjetë vetë që duhej të kishim, ne kemi vetëm shtatë. Kemi edhe detyrime që rrjedhin nga rezoluta juaj, që ne t'i marrim në dorëzim sa më parë. Së pari, ne kërkojmë plotësim të organikës së arkivit me tre vetë.

Për sa i përket Departamentit të Informimit, aty është vënë re dyfishimi i numrit të kërkesave të individëve, është vënë re një rrije e kërkesave për verifikim të figurave. Deri tash kemi verifikuar rreth një mijë figura. Me vetingun e policisë presim që 12 mijë persona të kalojnë nga filtri ynë, dhe me vitin zgjedhor që kemi, kur tashmë është dekretuar edhe data e zgjedhjeve vendore, ne presim rreth një mijë struktura të tjera.

Në departamentin e informimit kemi 5 vetë, ndërkohë që duhej të kishim

14. Kjo është akute, sepse na pengon në plotësimin e detyrimeve ligjore, të cilat rrjedhin qoftë nga ligji ynë, qoftë nga ligji i vlerësimit kalimtar të punonjësve të policisë.

Përveç kësaj, më lejoni t'ju them se edhe në lidhje me kërkesat individuale, arkivi është me gjashtë muaj vonesë. Pra, njerëzit presin gjashtë muaj në arkiv. Për sa u përket vendimeve të deklasifikim-anonimizim kërkohet edhe një gjashtëmuajsh tjetër, dhe është e pafalshme t'i lëmë qytetarët e moshuar të presin një vit e ca. Është gjynah, se për rrjedhojë bie edhe kredibiliteti i të gjithë procesit. Pra, vërtet jemi të shqetësuar.

Për sa u përket kërkesave për studim nga Departamenti i Posaçëm, janë aprovuar pesë vetë, por kemi vetëm një. Duhet ta plotësojmë patjetër stafin, sepse kemi gjashtë marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike. Janë të gjitha funksionale. Është rritur maksimalisht eficientia, është trefishuar numri i studimeve, kemi filluar konferencat ndërkombëtare. Javën e

kaluar u zhvillua me shumë sukses. Kishim 34 kumtesa dhe në një nivel shumë të lartë, mirëpo në kushtet ku ndodhemi, pa personelin përkatës, efienca jonë bie.

Kjo ishte për sa i përket personelit.

Të lutem Altin, shpërndaja organikën kryetarit dhe anëtarëve të komisionit!

Pra, ne do të donim ta plotësonim organikën me 30 personat që na mungojnë. E përsëris: është një strukturë e miratuar nga parlamenti, por deri tani është vetëm 40 % e strukturës. Edhe me vetëm dhjetë vetë do të mund të ishim në kufijtë e arsyeshëm, që të paktën të marrim pak frymë e të bëheshim gati, sidomos për Departamentin e Arkivit, të informacionit, kërkimin, si dhe të bëhemi gati për vetingun e policisë e verifikimin e figurave në rastin e zgjedhjeve.

Shqetësimi i dytë ka të bëjë me mungesën e madhe të investimeve. Këtu, do të doja t'i kujtoja zotit relator, komisionit dhe kryetarit të nderuar, që vjet, në këtë kohë, kemi biseduar në lidhje me nevojën tonë për investime. Siç jeni në dijeni, na është vënë në dispozicion një godinë e përshtatshme, por ajo ka nevojë të adoptohet.

Vjet u diskutua me shumë realizëm, dhe relatori, së bashku me anëtarët e komisionit, e mbështetën kërkesën tonë, të paktën për të filluar lotin e parë të investimit, nëpërmjet të cilit arkivi do të akomodohej mirë dhe ne do të fillonim të sponsonim arkivin. Këtë vit ne nuk e morëm këtë buxhet, Komisioni i Ekonomisë nuk e aprovoi. Ne kemi bërë një lobim, kemi bërë dhe presionin tonë, me argumente e në mënyrë shkresore, të përsëritur. Për fat të mirë, në verë, në korrik, na u bë një lëshim: na u dhanë 10 milionë lekë, me një akt normativ. Kësisoj ne kontraktuam lotin e parë, por natyrisht, ky lot duhet të plotësohet me 23 milionë lekë, me qëllim që ne të bëjmë gati arkivin, të paktën arkivin, se është një e treta e godinës, si dhe sistemet e përshtatshme, që të paktën që arkivin ta çojmë aty.

Kjo kërkesë bëhet më akute, zoti relator do t'ju kërkoja tërë vëmendjen juve dhe zotit kryetar, sepse kemi marrë njoftim zyrtar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ja, do t'ju shpjegoj. Ne kemi bërë edhe skenarin minimalist, edhe skenarin maksimalist. Skenari minimalist bëhet shumë akut, sepse neve na ka ardhur njoftimi...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Skenari minimalist është përfundimi i lotit të parë me 23 milionë lekë, të paktën loti i parë. Njoftimi për të lëvizur edhe nga zyrat ku jemi, te Garda, na vë vërtetë para përgjegjesisë. Ne

nuk kemi ku të shkojmë, për sa kohë kemi godinën tonë. Me kaq lekë, ajo godinë nuk do të bëhet si do të donim ne, por të paktën do të fusnim kokën.

Na është dhënë njoftimi zyrtar, është marrë vendimi i qeverisë, që Garda do të përdoret për qëllime të tjera. Atëherë, administrata do të ngelet vërtet pa zyra.

Sido që të jetë, me plotësimin e lotit të parë ne jemi në rregull. Një gjë e mirë, që është edhe një argument që dua ta ndaj me ju, është se jemi në tratativa me qeverinë suedeze. Kemi marrë edhe me shkrim sinjale pozitive, që ata të plotësojnë lotin e dytë, ku është pjesa e aktiviteteve dhe e administratës, por pa lotin e parë, ata nuk na përgjigjen dot.

Kështu, loti i parë është vërtet akut, mbështetur në të gjitha arsyet që përmenda. Është një bisedë e bërë që vjet. Vjet e kemi marrë mbështetjen nga ju. Thjesht duhet të bëhemi të gjithë bashkë dhe t'i japim mundësi institucionit që të funksionojë minimalisht, se nuk po them maksimalisht.

Për sa u përket aktivitete dhe ju e dini se ne kemi qenë shumë të suksesshëm në zhvillimin e aktiviteteve dhe i kemi bërë përmes financimeve me donatorë, por donatorët në mënyrë të prerë nuk kanë mbështetur as këtë, as investimet, por kanë mbështetur vetëm pjesën e konferencave, ekspozitave dhe botimeve, me të cilat kemi punuar.

Më lejoni t'ju them se është një projekt i madh, është projekt kombëtar. Ka pasur jehonë të gjerë, është përqaftuar nga njerëzit e të gjitha ngjyrave politike.

Më kujtohet një rekomandim që relatori na e dha vjet, që të shkojmë në pushtetin vendor. Ne e kemi kryer dhe i kemi në radhë bashkitë, të cilat kërkojnë të fillojnë punën me dialogun lokal, të zbresin në terren. Të gjitha këto kërkojnë, që të paktën të kemi skenarin minimalist të plotësuar. Po e përmbledh, skenari minimalist përfshin, të paktën 10 persona, nga 30 për ta plotësuar organikën, jo për ta shtuar. Investimi për dixhitalizimin, pasi ju kam thënë, po kërkojmë financim, vazhdojmë duke kërkuar financim. Nuk po kërkojmë fonde nga qeveria për godinën, të paktën loti i parë është deklasifikuar, më shpëtoi si detaj, është një detaj që duhet ta dini, bëhet fjalë për një arkiv të klasifikuar, i gjithë tenderi është i klasifikuar. Ne kemi lidhur kontratën me 10 milionë, 23 milionë na duhen patjetër që të përmbysim pjesën e arkivit. Është 1 mijë metër katror godinë dhe sistemet. Spostimin nga Garda do ta bëjmë në mënyrë partizane, e thënë më shqip, por do të kemi një proces dinjitoz, pasi do të vazhdojmë punën dhe do të bëhemi gati për vetingun e policisë, për zgjedhjet.

**Ulsi Manja** - Dakord.

Faleminderit, zonja Sula!

Zoti Fino bëhet fjalë për skenarin minimalist për 10 shtesa dhe për një fond investimi për rehabilitimin e godinës prej 23 milionë lekësh të rinj.

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** - Mua më duket pak absurde, nëse ne kemi miratuar strukturën me 60 vetë, nuk e kuptoj pse janë 30. Drejtoresha, na kërkon që ta plotësojë strukturën. Nga ne e ke marrë dakordësinë. Ne e kemi votuar dhe kemi thënë se do të jenë 60, që do të thotë se në momentin që ka dalë vendimi i parlamentit, ai duhet të respektohet. Bëhet fjalë për numrin, edhe sikur të themi ne në kërkesën tonë drejtuar Komisionit të Ekonomisë për të shtuar 10 persona, për çfarë t'i themi, për atë vendim që kemi marrë?! Ne kemi marrë një vendim kur ka kaluar struktura dhe kemi thënë se kjo do të jetë me 60 persona. Nëse u themi atyre, se këta kanë marrë 30 në punë, të marrin edhe 10 të tjerë? Pra, nuk e kuptoj, se ne e kemi marrë vendimin. Nuk e di sesi e keni formulimi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti kryetar, tani e kuptova, në tabelën 2 që kemi këtu, thuhet: "Projektbuxheti i vitit 2019 do të ketë 82 mijë e 22 vetë". Kaq është emërtimi i ministrive, institucioneve buxhetore, duke filluar nga Presidenti i Republikës deri te institucioni i rezervës dhe institucionet e drejtësisë. Tani, siç po ma shpjegon sekretarja e Përgjithshme e ministrisë, do të thotë që ju në këto 82 mijë vetë që ka buxheti, keni 30 vetë. Jeni 30 vetë, megjithëse është miratuar me 60 vetë. Ai projekt që ne kemi miratuar, vendimi ynë nuk është reflektuar, por me 30 vetë, aq sa ka në punë. Del e domosdoshme, imediate që t'i shtojmë 10 vetë. Këtu të mos jetë 82 mijë e 22, por 82 mijë e 32. Të shtohen, të paktën, minimumi edhe 10 vetë. Jam dakord, e kam dëgjuar këtë diskutim edhe vitin e kaluar, thamë se do të fillojmë investimet. Jam dakord që t'ia dërgojmë Komisionit të Ekonomisë lotin e parë prej 23 milionë lekësh për investimet, sepse është shumë e domosdoshme, nëse ne duam ta ndihmojmë këtë institucion të ri që është ngritur. Pra, pasi e verifikova, ne duhet t'i dërgojmë Komisionit të Ekonomisë shtesën prej 10 vetash.

Zonja Sula, ju duhet të bëni një strukturë të re për 40 vetë dhe jo për 60. Sepse 40 janë të pasqyruar në buxhet dhe ne duhet ta bëjmë këtë gjë. Duhet të kërkojmë patjetër 23 milionë lekë për investimet. Këto dy gjëra mendoj se duhet t'ia japim patjetër. Të paktën të keni njerëzit për të punuar.

**Ulsi Manja**- Faleminderit, zoti Fino!



Të dëgjojmë përfaqësuesen e Ministrisë së Financave.

**Gelardina Prodani-** Vazhdojmë me qëndrimin se duhet të paraqiten te Komisioni i Ekonomisë.

**Ulsi Manja** - Faleminderit!

Ka pyetje nga kolegët?

Zoti Hyseni ka kërkuar fjalën.

**Alket Hyseni** - E kërkova fjalën nisur nga ideja se zoti Fino do të ishte barrierë, por ishte brilant në logjikën e tij.

Ne kemi një detyrë në Komisionin e Ligjeve, që institucionet, të cilat paraqiten këtu për buxhetin dhe kanë kushtëzime ligjore duhet t'i mbështesim. Pastaj është detyra e Komisionit të Ekonomisë dhe e qeverisë që brenda atij grupi të madh, parashikimit të shportës së punonjësve të shikojë se ku mund të pakësojë dhe kushtëzimet ligjore duhet t'i plotësojë. Vetë Ministria e Financave kur është miratuar kjo strukturë edhe nëse ka qenë kundër, në momentin që votohet është e detyrueshme. Fatmirësisht, drejtoresha thotë se nuk i do të gjitha menjëherë, jo se nuk i do, por tregohet realiste dhe kërkon në kushte minimale vetëm 10 vetë. Kjo nuk diskutohet. Nuk duhet të vazhdojmë më debatin për këtë gjë. Nuk duhet ta vazhdojmë debatin edhe për lotin e parë. Ose t'u themi: si institucion i ri, rrini kot, mos e bëni detyrën!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jam dakord me ju zoti Fino, që sa herë ka kushtëzime ligjore, për vendin e punës, nuk duhet t'i diskutojmë fare. Le të jetë mbi numrin 82 mijë. Nuk na duhet fare kjo gjë. Ai numër nuk është i palëvizshëm ose është i menaxhueshëm brenda. Do të lodhim Ministrinë e Financave, por duhet ta menaxhojnë ata. Ne kemi detyrë që t'u themi, se ky është kushtëzim ligjor, ky numër është i padiskutueshëm. Ky investim është i domosdoshëm. Kaq kemi detyrë ne si komision. Ne nuk bëjmë filtrin, atë e ka Ministria e Financave. E bëra diskutimin, pasi mendova se zoti Fino, do t'i pranonte pjesërisht, për sa kohë u pranuan...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Sula, si rrallë institucione vjen me dy alternativa dhe thotë: “Kjo është idealja, por kjo është ajo që mund të kavardisemi për të mbijetuar dhe për të përmbushur funksionin tonë”. Unë e mbështes.

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zoti Hyseni!

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit!

Unë e ndoqa me vëmendje prezantimin e zonjës Sula dhe materialin që na u vu në dispozicion. Jam dakord me të gjithë angazhimin dhe punën që është bërë. Autoriteti ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë në informimin, sensibilizimin dhe është në përputhje me rezolutën e Kuvendit.

Kam dy pyetje, pasi dua të qartësohem. Ne vjet kemi miratuar një buxhet që nuk ka qenë i mjaftueshëm për ristrukturimin e godinës që keni. Në dijeninë time ju jeni ndarë në dy pjesë. Një pjesë të ish-Garda e Republikës. Çfarë është bërë me këtë investim?

E dyta, vjet keni kërkuar para për dixhitalizimin. Ne ju dhamë një shumë simbolike, pasi kishit një projekt gjerman. A është mbyllur procesi i dixhitalizimit të dokumenteve të arkivit?

**Ulsi Manja**- Po, zonja Sula.

**Gentiana Sula** - E nderuar deputete,

E para, në lidhje me pyetjen për buxhetin që u diskutua këtu në komision një vit më parë, vërtet ne e morëm mbështetjen, por pastaj Komisioni i Ekonomisë nuk e aprovoi dhe për vitin e kaluar morëm vetëm 2 milionë lekë investime. Imagjinoni vetëm për mjete pune.

Për sa i përket dixhitalizimit, ne përsëri nuk morëm, sepse 2 milionë lekë nuk janë asgjë, por morëm një ndihmë minimaliste nga ambasada gjermane. Ne bëjmë dixhitalizime rast pas rasti. Përsëri këtë vit po bëjmë aplikime, por në kuptimin e shkallës së gjërave ashtu siç duam ne, është shumë larg. Është projekt goxha i madh. Ne do të bëjmë përpjekje për të ngritur fonde me donatorë, por godina dhe staf i do të mbeten detyrë e qeverisë.

Ju falënderoj që ju na mbështesni, por ndihemi të pafuqishëm, sepse të gjithë na thonë: po, por kur vjen puna në letër, nuk e shikojmë të realizuar! Prandaj, le të mos mbetet në letër këtë herë. Na thoni se çfarë duhet të bëjmë?

**Ulsi Manja** - Ka një pyetje zonja Bushka.

**Klotilda Bushka**- Faleminderit, zoti kryetar!

Më vjen mirë që jemi të gjithë dakord. Pjesa e rikonstruksionit dhe përshtatja e godinës së dhënë për arkivin, patjetër që duhet të bëhet. Nuk është vetëm çështja ta bëjmë ne në raport. Duhet të bëjmë një mbledhje të përbashkët, ne si komision me Komisionin e Ekonomisë dhe Financës. Kjo çështje duhet të mbarojë, u bënë 2 vjet dhe duhet të marrë një drejtim.

Pyetja që kam për zonjën Sula ka të bëjë me stafin prej 10 vetash që kërkoni, në fakt e keni, a i plotëson nevojat?

Nëse ne do të fillojmë një diskutim për të akomoduar këto nevoja, se duhet të keni në konsideratë faktin, që do të filloni vetingun në polici, a keni çështje të tjera për organet e reja që po ngrihen dhe kanë nevojë për verifikime. Kushtet e arkivit me sa kemi kuptuar i keni të tilla që nuk ju lehtësojnë fizikisht në kohë dhe në punë për të proceduar të dhënat në kohë të shpejtë? Nëse këtë numër e keni verifikuar, e keni thënë se kaq e keni limitin dhe nuk shkoni dot më tutje, apo e keni bërë llogarinë? Nëse do të investohemi të bëjmë një diskutim, na i jepni kërkesat ashtu siç janë, pavarësisht se nuk jam ekonomiste, por e di që nga pikëpamja e funksionit që kemi, të dërgojmë nevojat reale që keni dhe më pas të arrijmë atje ku mundemi. Problemi është që të bëjmë diçka që t'ju shërbejë dhe të mos kemi këtë situatë, pasi do të vini përsëri vitin tjetër dhe jemi në vend numëro për 1-2 stafe më tepër.

**Ulsi Manja** - Zonja Sula, jeni dakord?

**Gentiana Sula** - Ne kemi bërë diskutimin për organikën. Kishim kërkuar më tepër, debatuam këtu, mbërritëm te 60-ta. Sigurisht që na duhen të gjitha. Ne presim 6-fishim të numrit të verifikimit të figurave. Ne jemi funksionalë, por varet te koha, në të cilën bëjmë shërbimin. Kërkesa për informim, nëse do një vit, në këto kushte do të marrë 2 vjet. Numri i studiuesve është trefishuar, është dyfishuar numri i individëve, është gjashtëfishuar numri i vetingut.

Arkivi është fletë për fletë. Kemi identifikuar fonde të reja. Ne i kemi të dyja versionet, sigurisht që unë i kërkoj të plota. Po dëgjoj të qeshura nga përfaqësuesit e Ministrisë Financës dhe nuk guxoj as t'i ndërroj, sepse kemi pasur një mbështetje zero.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kuptoj, por vërtet ndihemi që është në kufijtë e pamundësisë. Unë ku ta gjej që t'i kem të gjitha.

**Ulsi Manja**- Dakord.

Zonja Sula nuk kemi pse vazhdojmë më tepër. Unë bashkohem me mendimin e kolegut Fino, që Kuvendi, Komisioni i Ligjeve duhet të kërkojë zbatimin e strukturës që ka miratuar vetë. Në fund të fundit, të shkelurit e parë jemi ne. Kjo është e gjitha. Ne kemi miratuar një strukturë me 60 vetë, është miratuar me vendim të Kuvendit. Unë nuk i heq asnjë presje asaj që tha zoti Fino. Ne nuk kemi pse i lutemi askujt për të shtuar 5,10 apo 20. Ne do të kërkojmë zbatimin e vendimit që ka miratuar Kuvendi në seancën plenare. Edhe sot nuk e kuptoj arsyen pse në numrin e përgjithshëm të punonjësve prej 82 mijë e 22 vetë, nuk është reflektuar, të paktën si numër.

Ju lutem!

Ta përmbylim tani, se janë edhe institucione të tjera. Të gjithë vijnë për të kërkuar.

Do t'i kërkojmë Komisionit të Ekonomisë, edhe unë do të investohem së bashku me relatorin, por edhe me kolegët, që të pakën 10 persona dhe 230 milionë lekë investime të bëhen pjesë e paketës së buxhetit të vitit 2019 që do të votohet në Kuvend.

Këtu besoj ta mbyllim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

23 milionë lekë të rinj për godinën për Autoritetin e Informimit.

**Gentiana Sula** - Kam një ftesë, ju kemi ftuar për një ditë të hapur në arkiv, që ta shikoni.

**Ulsi Manja**- Kjo po.

**Gentiana Sula**- Do t'ju pëlqejë, sepse do të kuptoni shumë gjëra.

**Ulsi Manja** - Jemi shumë dakord. Bashkohem me atë që tha relatori, që së bashku me kolegët, shpresojmë që në Komisionin e Ekonomisë ta marrim këtë që sapo vendosëm.

Zonja Sula, shumë faleminderit për prezencën në komision, së bashku me të gjithë kolegët e këtij Autoriteti, zotin Miraka, zotin Hoxha, zonjën Shtino dhe zonjën Fuqi!

Ditë të mbarë!

Vazhdojmë me Institutin e Studimit të Krimit dhe Pasojave të Komunitetit.

Kanë ardhur në komision zonja. Zoica Graçi, financiere dhe zoti Çelo Hoxha, zëvendësdirjtor.

Ju lutem zini vendet!

Zoti Hoxha, mirë se erdhët në komision!

Do t'ju lutesha që shumë shkurt të na flisnit për nevojat e institucionit tuaj, a janë akomoduar kërkesat buxhetore nga Ministria e Financave dhe për çfarë mund t'ju mbështesim sot si komision?

**Çelo Hoxha** – I nderuar zoti kryetar!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Po kaloj direk në çështjet financiare.

Plotësimi i kërkesave tona nga Ministria e Financave në raport me buxhetin që kemi ka qenë i mirë. Nuk ka ndonjë problem. Ne kemi vetëm një kërkesë këtë vit për çështjen e një makine, pasi kemi një shumë të vjetër, e cila është e konsumuar, është makinë varrezash, me harxhim shumë të madh. Ne kërkojmë një fond prej 2 milionë lekësh të rinj për të blerë një të tillë, sepse na duhet për punën e përditshme të institucionit për realizimin, sidomos të intervistave me

personat, me ish - të përndjekurit politikë. Ne dalim edhe jashtë rretheve, sepse një pjesë e tyre janë jashtë Tiranës dhe nuk mund të vijnë për shumë arsye. Makina që kemi tani nuk e përballon dot këtë punë. Nuk kemi ndonjë gjë tjetër.

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zoti Hoxha!

Të dëgjojmë përfaqësuesit e Ministrisë së Financave.

**Gelardina Prodani** - Nuk kemi gjë për të shtuar.

**Ulsi Manja** - Nuk keni gjë për të shtuar, por në fakt unë dua të di lidhur me Institutin e Studimit të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit, a e keni plotësuar strukturën organike edhe në lidhje me shtesat që ju kemi dhënë si komision, të cilat janë kaluar?

**Çelo Hoxha** – Aty ka një ngërç, sepse është miratuar në komision së bashku me buxhetin, por nuk ka kaluar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** - Ju lutem!

**Çelo Hoxha** - Ngërçi është me Kryeministrinë.

**Ulsi Manja** – Është brenda numrit të strukturës që ju keni shtesa prej 4 personash?

**Çelo Hoxha** – Nuk është funksionale. Ka 2 vjet që digjen fondet e tyre. Janë fonde që na janë hequr, sepse janë hequr nga botimet dhe kanë kaluar te këto.

**Ulsi Manja** – Dakord. Unë kam një komunikim me qeverinë që më 30.04.2018 lidhur me miratimin nga Këshilli i Ministrave të strukturës edhe me këta 4 persona shtesë që ju keni kërkuar dhe janë miratuar në Kuvend. Kjo mbetet për ta ndjekur ne si komision, pra zbatimin e plotësimit të strukturës dhe organikës me 4 personat që ne ju kemi miratuar në Kuvend.

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Projektbuxheti i këtij institucioni ka rritje të konsiderueshme në raport me vitin 2018. Pra, shpenzimet në miliona lekë, nga 33,7 që janë sot, në vitin 2019 do të jenë 36,6 milionë, pra ka një rritje të konsiderueshme, madje ka edhe rritje në investime, ka rreth 2 milionë investime, që nuk e di se ku do t'i bëjnë vitin tjetër...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ku do t'i bësh investimet, se ti zyrat i ke? Unë kam një propozim konkret që Ministria e Financave mund ta ndryshojë këtë zërin e investimeve, duke e kaluar në rregullime ose blerjen e një mjeti që kërkoni, pavarësisht se ne, në përgjithësi, të gjitha institucioneve nuk u kemi dhënë asnjë mjet, se edhe ne deputetët nuk kemi makina, por shkojmë vetë në zonë, i bëjmë vetë punët,

prandaj edhe ju duhet t'i bëni vetë punët, boll që ne ju japim shpenzimet, ju japim pagën dhe ju shkoni të bëni punën, edhe kur shkoni në rrethe të tjera.

Gjithsesi, unë propozoj që ky projektbuxhet të ngelet siç është se është shumë i mirë dhe këta duhet të jenë të lumtur dhe të kënaqur.

Për çështjen e strukturës, e thatë ju vetë, ndërsa 2 milionë investime e kalon në investime për blerjen e makinës dhe jemi në rregull, në qoftë se pranohet nga Ministria e Financave.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Urdhëroni, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave!

**Gelardina Prodani** – Fondi i investimeve është miratuar. Detajimi i investimeve bëhet pasi kalon miratimi i ligjit të buxhetit. Do ta ngremë këtë çështje dhe të shohim pastaj si do të bëhet.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Në fakt, Ministria e Financave e vendos filtrin më të hollë, kur bëhet fjalë për automjete dhe rikonstrukcion, por do jetë vendimmarrje...

**Ulsi Manja** - Faleminderit!

Besoj se do të jemi në kontakt edhe me financën e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit dhe, pse jo, meqenëse është mundësia, pa shtuar gjë, që të bëhet ky kalim fondesh, edhe ne jemi dakord dhe do t'ia sugjerojmë edhe komisionit përgjegjës.

Faleminderit, zoti Hoxha dhe zonja Graçi për prezencën tuaj!

Vazhdojmë me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Kemi prezent sot në komision zonjën Adriana Hala, drejtoreshë e Procedurave Ligjore, zonjën Mirela Rrumbullaku, drejtoreshë e Shërbimeve Mbështetëse dhe zotin Erion Lili, specialist i financës.

Mirë se erdhët në komision!

Do t'ju lutem që shumë shkurt të na thoni nevojat buxhetore të institucionit tuaj, sa ato janë marrë në konsideratë për këtë vit buxhetor nga Ministria e Financave dhe çfarë mund të dakordësojmë ne si komision me Ministrinë e Financave për t'i ardhur në ndihmë institucionit tuaj.

Urdhëroni, zonja Adriana!

**Adriana Hala** – Mirëdita, të nderuar deputetë!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka bërë parashikimet e veta për buxhetin e vitit 2019. Ne kemi vetëm dy sugjerime për buxhetin e vitit 2019.

E para, ka dalë një vendim i Kuvendit të Shqipërisë më 23.7.2018 “Mbi ndryshimin e strukturës së komisionerit dhe rritjen e numrit të punonjësve nga 25 në 34”. Nuk e di çfarë ka ndodhur, por në buxhetin e vitit 2019 nuk është parashikuar numri 34 i punonjësve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por është lënë 25 përsëri.

E dyta, kemi një zbritje për 2,7 milionë lekësh të buxhetit të komisionerit, të cilat janë zbritur nga investimet dhe nga shërbimet, por mendojmë se duhet të rikonsiderohet dhe të merret parasysh kjo shumë, pasi rritja e numrit të punonjësve ka edhe rritje të investimeve dhe të shpenzimeve në shërbime.

Doja të sillja në vëmendjen tuaj kërkesën e vazhdueshme të komisionerit për ambiente të reja pasi në ambientet ekzistuese ne nuk kemi mundësi të rrisim numrin e punonjësve të parashikuar nga Kuvendi dhe do të doja që të merrej në konsideratë nga Ministria e Financave, që në rast se ne marrim ambiente të reja, investimet për ambientet e reja, në qoftë se ato do të kenë, ne nuk e parashikojmë dot se sa mund të jenë këto investime, por kërkesa jonë e vazhdueshme për ambiente të reja na çon në kërkesën edhe të investimeve.

Te Fondi Shqiptar i Zhvillimit kemi një kat, katin e dytë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** – Po FSHZH-ja është OJF dhe merr fonde. Pse ia jepni?

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zonja Hala, a përfunduat?

Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Unë e kam shumë të thjeshtë me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminim.

Me këtë komisioner, së bashku me tre komisionerët e vetingut, ne jemi marrë para një muaji e ca, duke ndryshuar strukturën e të tjera. Ministria e Financës është e detyruar të respektojë vendimmarrjen e parlamentit për numrin e punonjësve, për shpenzimet e të tjera me radhë, prandaj edhe ky komisioner, zonja në fjalë, ka plotësisht të drejtë, sepse ne kemi bërë një ndryshim në strukturën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminim, e kemi me 34 veta. Në regjistrat që kam unë është gabim numri 25, prandaj do të korrigjohet. Duhet të merret vendimi i Kuvendit, i cili është miratuar para dy muajsh dhe në funksion të këtij numri, automatikisht bëhen llogaritjet e

fondit të pagave, të sigurimeve dhe natyrisht që do të ketë edhe rritje të shpenzimeve korrente, sepse do të llogaritet për 34 veta fondi i pagave, jo për 25.

Për sa i përket problemit të dytë, është një çështje, të cilën ne nuk e zgjidhim dot tani, as Ministria e Financave nuk e zgjidh dot, sepse drejtoresha thotë që më programoni ca fonde për mua, që, nëse unë do të gjej zyra të reja më duhet t'i rregulloj dhe t'i kem lekët gati. Po nuk t'i jep ashtu njeri lekët gati, se edhe në shtëpi po të jesh, në buxhetin tëndin dhe timin bashkë, duhet ta gjejmë gjënë që ta investojmë. Gjejini ju ambientin me sekretarin e Këshillit të Ministrave, me qeverinë apo ku mund të gjeni ambiente dhe pastaj kemi mundësi gjatë vitit, se ka edhe fond rezervë qeveria që mund t'ua japë.

Po ne do të respektojmë atë strukturë që kemi miratuar këtu, madje, më lejoni t'jua them, se keni 2 milionë investime për buxhetin e vitit 2019, që do të thotë se, nëse ju nuk keni se ku të harxhoni se nuk keni mundësi, këto janë treguar dorëlëshuar, për mendimin tim, sepse 1 milionë e kishit në vitit 2018 dhe ju kanë dhënë 2 milionë tani, që do të thotë: ja ku i ke lekët, nëse nesër gjen një mundësi për zyra të reja.

Ne nuk po ta prekim këtë 2- milionësh, por ti nuk e di për çka e planifikon këtë investim se nuk keni zyra. Ndërkohë, ajo që dua të them është se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka një strukturë të caktuar, të cilën e kemi miratuar dhe fondet e pagave dhe të gjithë të tjerat do të jenë në funksion të strukturës së re.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Edhe në rastin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ne kërkojmë zbatimin e vendimit të Kuvendit.

Kështu që, kjo është përgjegjësi e jona, zonja Hala.

Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Lidhur me shqetësimin që keni ngritur, zonja Hala, lidhur me godinën, ne jemi në dijeni, në bazë të letrës së adresuar në Kuvendin e Shqipërisë dhe jemi në tratativa me Këshillin e Ministrave, me sekretarin e Përgjithshëm, për t'i dhënë një zgjidhje këtij problemi dhe unë besoj se duke çuar edhe vendimin që Kuvendi i Shqipërisë ka marrë më parë edhe rritjen e numrit të punonjësve, për rrjedhojë edhe numrin mjediseve, besoj se do të kemi një zgjidhje pozitive.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!



Duke qenë se jeni në një godinë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, po të kishit gjetur gjuhën e mirëkuptimit, ata mund t'ju kishin bërë edhe godinë të re.

**Adriana Hala** – E para, për shumën që kemi për investimet, aty nuk janë vetëm investime për godinën, por janë edhe pajisje për numrin e ri të punonjësve, kompjuteri dhe mjete pune, pastaj shumë mirë do të ishte nëse Fondi do të na bënte godinë të re, por nuk e sheh të arsyeshme.

**Ulsi Manja** – Faleminderit për prezencën tuaj në komision, zonja Hala!

Ditë të mbarë!

Vazhdojmë me institucionin e fundit në radhë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Zoti Xhevdet Haxhiu, drejtor i drejtorisë së administratës dhe financës dhe zoti Arian Parruca, përgjegjës i sektorit të financës.

Zoti Haxhiu, do t'ju lutem që shumë shkurt të na thoni nevojat buxhetore të institucionit tuaj, sa ato janë marrë në konsideratë për këtë vit buxhetor nga Ministria e Financave dhe çfarë mund të dakordësojmë ne si komision me Ministrinë e Financave për t'i ardhur në ndihmë institucionit tuaj.

**Xhevdet Haxhiu** - Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Të gjitha kërkesat që ne kemi bërë janë konform vendimit të KM-së për miratimin e tavaneve, por kemi vetëm një kërkesë mbi tavanet e miratuara që ka të bëjë me pagat edhe sigurimet shoqërore, të cilat janë në një tejkallim në shumën 28 mijë lekë.

Ky tejkallim vjen si rezultat i ndryshimit të nivelit të pagave të inspektorit të inspektoratit të KLD-së, të cilët gëzojnë statusin e gjyqtarit.

Sot, me ligjin 96/2016 gëzojnë statusin e magjistratit dhe bazuar në këtë ligj dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.34, datë 10.04.2017 ato kalojnë në nivelin “G2”, që i bie afërsisht shuma

...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Për sa i përket veprimtarisë së KLD-së jemi dakord, por dua të ngre një shqetësim. Ne si administratë ekzistuese po përballojmë edhe një punë voluminoze në mbështetje të organeve të vetingut. Duhet të theksoj se ndryshimet kushtetuese dhe kuadri i ri ligjor, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, parashikon ndryshime thelbësore në institucionin tonë duke konsistuar në ngritjen e institucionit të ri, i cili do të kërkojë domosdoshmërisht për vitin 2019 rishikimin e kërkesave

buxhetore. Në këtë kontekst është një nevojë shumë urgjente, duke menduar që në fillim të vitit do të ngrihet institucioni i ri, një godinë tjetër, pasi, siç parashikon ligji, bashkimi i administratës ekzistuese të KLD-së, së bashku me administratën ekzistuese të ZABGJ-së gati dyfishohet numri dhe është e pamundur në godinën që ne kemi të sistemohen këto punonjës, pasi aktualisht vetëm 50 punonjës mund të akomodohen në ato ambiente që kemi.

Po kështu, është parashikuar edhe ngritja e qendrës së IT-së për gjyqësorin, që është parashikuar në takimet që kemi pasur me organizmat mbështetës të reformës së USAID-it dhe EURALIUS-it, qendra e IT-së do të vendoset pranë ambienteve të KLGJ-së. Po kështu, salla e mbledhjeve, me sistemim audio dhe video duhet të jetë funksionale që në momentin e parë, se, siç parashikon ligji, brenda 3 ditëve do të bëhet mbledhja e parë e konstituimit të këshillit...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Mund ta përmblihdni, zoti Haxhiu. Ne kemi përgjigje për të gjitha shqetësimet tuaja. Kemi marrë edhe një letër tuajën dhe ne kemi përgjigje për gjithçka, sepse ju jeni pjesë shumë e rëndësishme e reformës në drejtësi dhe funksionimi i institucionit tuaj për momentin lidhet me krijimin e KLGJ-në dhe që në fondin e kontigjencës së qeverisë për zbatimin e plotë të reformës në drejtësi janë paraparë të gjitha gjërat.

Do t'ju lutesha të fokusoheni tek ato që tha relatori, zoti Fino.

**Xhevdet Haxhiu** – Desha ta shpreh këtë shqetësim sepse ne nuk kemi pasur mundësi ku ta shprehim këtë shqetësim. Barra më e rëndë që bie mbi administratën ekzistuese, vërtet janë periudhat e tranzicionit, por ne kemi një ngarkesë shumë të madhe në funksion dhe në mbështetje të dy organeve të vetëngut.

Shqetësimin për godinën është edhe shqetësimi i dy partnerëve tanë që na asistojnë, EURALIUS-i dhe USAID-i, madje me kërkesë të tyre më është kërkuar që unë ta nge këtë shqetësim, se nuk kam ku e ngre në vend tjetër.

**Ulsi Manja** – Shumë mirë bëni që e ngrini shqetësimin. Me USAID-in dhe EURALIUS-in, për jetësimin e zbatimit të plotë të reformës në drejtësi, autoritetet shqiptare janë në kontakte të përditshme dhe të vazhdueshme dhe unë si kryetar i Komisionit të Ligjeve kam përgjigje për të gjitha shqetësimet që ju keni në mbarëvajtjen e punës së administratës transitore, por edhe të asaj që do të vijë, që shpresojmë të jetë funksionale në fillim të vitit që vjen.

Çështja e godinës dhe çështjet e organizimit të institucionit të ri janë pjesë e një diskutimi tjetër.

Gjithsesi, mund të vazhdoni.

**Xhevdet Haxhiu** – Për sa u përket kërkesave buxhetore për KLD-në për vitin 2019, përveç tejkalimit që kanë të fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore, për sa u përket pagave që rriten me datën 1 janar 2019 për inspektorët që gëzojnë statusin e magjistratit, unë nuk kam shqetësim tjetër.

Jemi dakord me të gjitha kërkesat e tjera.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Haxhiu!

Urdhëroni, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Buxheti i KLD-së është buxhet super i mirë. Me lejoni t'ju them vetëm disa shifra.

Shpenzime totale të KLD-së për vitin 2019, që qeveria ka parashikuar, janë 127 milionë e 300 mijë lekë, ndërkohë që e kishte 89 mijë (shpenzimet).

Tani, problemi këtu qëndron që fondin e kontigjencës qeveria e ka të fondet e nevojshme për reformën në drejtësi. Pyetja që kam unë, e kisha edhe për Avokatin e Popullit, e kam edhe për ty si kryetar: Këta inspektorët e KLD-së a e kanë bërë vetingun? A janë pastruar nga vetingu këta? Kështu na rezulton se gjyqtarët dhe prokurorët, që e kanë kaluar vetingun, do të marrin rroga të larta. Pra, rezulton se 16 inspektorët që janë këtu do të marrin rrogën si 16 presidentë. Presidenti, i cili sot drejton KLD-në, do të jetë një hiç, nga pikëpamja financiare, para rrogës që do të marrin këta inspektorë. Pra, rroga e re që do të marrin këta inspektorë nga 1 janari, kur këta ende nuk e ka kaluar vetingun, do të jetë 2 milionë e 700 mijë lekë (unë jam dakord që të zbatohet njëherë vetingu për këta inspektorë, në mënyrë që të mos e marrin pagën pa veting), ndërkohë që ne, me nenin 12, e kemi miratuar rrogën e Presidentit të Republikës 2 milion e 570 mijë lekë. Pra, kryetari i shtetit e ka rrogën 2 milionë e 570, të cilën ne e kemi miratuar me një nen të caktuar për të treguar hierarkinë e pagave, ndërkohë që inspektori i KLD-së do të marrë 2 milionë e 700 mijë.

*(Ndërhyje pa mikrofon.)*

Pra, një inspektor do të marrë mbi pagën e Presidentit të Republikës dhe janë 16 inspektorë. Pyetja ime është: a do të vetohen këta inspektorë? A do të ketë veting për ta, që do ta gëzojnë këtë punë, apo këta që ka dorëzuar KLD-ja do të marrin rroga nga 2 milionë lekë? Unë jam kundër, dhe pavarësisht se ka ligji, do të bëj namin në parlament për të gjithë ata që e marrin padrejtësisht rrogën dhe nuk ka një hierarki të pagës. Hierarkia e pagës fillon nga Presidenti i Republikës, sepse është ai i pari, më pas vjen e Kryeministrit, Kryetrari i Kuvendit dhe gjithë të

tjerët. Pra, nuk mund të jenë inspektorët të parët. Çfarë na del tani? Këtu na dalin 16 inspektorë, na dalin 5 komisionerë të Avokatit të Popullit, të cilët do të marrin këtë pagë.

Këtu neve na del se rëndon më shumë bishti se sqepari. Këtu nuk bëhet fjalë për kryetarin e KLGJ-së, sepse ai e ka bërë vetingun dhe do të jetë në krye të KLGJ-së, nuk bëhet fjalë për Avokatin e Popullit, sepse ai është zgjedhur nga ne dhe është një, por këtu bëhet fjalë për të gjithë punonjësit, që janë në funksion të tyre, bëhet fjalë për 16 inspektorë dhe 5 komisionerë. Pra, janë 21 vetë, që do të marrin më shumë rrogë se unë dhe Presidenti i Republikës. Çfarë janë këta? Për modesti janë zero para meje dhe Presidentit, por edhe para jush, sepse nga deputetët buron i gjithë pushteti që bëhet këtu. Pra, nuk mund të marrë një inspektor 2 milionë e 700 mijë lekë kur Presidenti i Republikës merr 2 milionë e 500 mijë lekë, pavarësisht se Ministria e Financave ka fondin e kontigjencës. Ne, si Komisioni i Ligjeve, duhet të këmbëngulim që ta verifikojmë situatën dhe duhet të kërkojmë të bëhet vetingu i këtyre njerëzve, sepse, në fund të fundit, këtë kemi kërkuar ne.

Unë jam pro vendimit që kanë ikur nga vetingu anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe shumë mirë kanë bërë që kanë ikur, sepse kanë marrë vendim për veten e tyre dhe kanë thënë se do të marrin pagat që u takojnë, kurse këta na paskan caktuar pagat e tyre. Ky është konflikt i pastër interesi. Ai vendim që kanë marrë ata, të cilin e solli këtu Avokatja e Popullit, po na degjeron me këto paga. Unë, si deputet, si anëtar i Komisionit të Ligjeve, por edhe si financier do të marr iniciativën në parlament që t'i dal kundër këtij vendimi. Si ka mundësi që një anëtar i Gjykatës Kushtetuese ta caktojë vetë pagën e tij, kur në Kushtetutë thuhet: “Kryeministri paraqet buxhetin në parlament”, por ky buxhet përshkruan pagat, shpenzimet dhe investimet? Nëse anëtarët e Gjykatës Kushtetuese i caktojnë vetë pagat e tyre, atëherë edhe unë si deputet mund ta kërkoj këtë gjë. Pra, të gjithë deputetët mund të mblidhemi këtu dhe të themi: “Nuk duam t’ia dimë për Edi Ramën dhe qeverinë, sepse ne si parlament do ta caktojmë vetë rrogën tonë 5 milionë lekë, sepse është buxheti ynë dhe nuk kemi punë me buxhetin e qeverisë”. Çfarë ndodh nëse të gjitha institucionet e pavarura e caktojnë vetë pagën e tyre? Ne kemi bërë një gabim tjetër, sepse kur kemi miratuar ligjet organike të këtyre institucioneve, në vend që të merreshim me funksionet e institucioneve përkatëse, jemi marrë me pagat e tyre. Ne bëjmë një ligj për KLD-në dhe themi se inspektorët do ta paguhen kaq apo aq.

Zoti kryetar, kush e ka bërë këtë propozim, që inspektorët do të paguhen me pagën e anëtarëve të Gjykatës së Apelit? Kush e ka bërë këtë propozim, po ju them, se është

antikushtetuese? Pra, kur bëjmë një ligj për KLGJ-në e re ne përcaktojmë si do të jenë normat dhe funksionet e punës së saj, por nuk mund të vendosim që inspektorët do të paguhet me pagën e anëtarit të Gjykatës së Apelit. Absolutisht jo! Këtë gjë nuk e kemi vendosur as ne kur kemi bërë ligje të tjera të rëndësishme si, për shembull, për pyjet, për pushtetin lokal e të tjerë, që inspektori do të ketë këtë apo atë rrogë, ndërkohë që ti e vendos këtu se ata do të marrin rrogën e anëtarit të Gjykatës së Apelit, pra më shumë se Presidenti i Republikës. A ka logjikë kjo?!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Kjo nuk ka asnjë logjikë, pavarësisht se buxheti për KLGJ-në është pothuajse i plotë nga Ministria e Financave. Unë jam kundër kësaj gjëje që është bërë dhe kërkoj mirëkuptimin tuaj. Unë do të sjell këtu një nismë dhe do ta quaj ligji “Fino”, që t’i rrëzojmë të gjitha vendime lidhur me pagat që janë vendosur pa të drejtë. Paga me hierarki fillon me pagën e Presidentit, që është më e larta. Presidenti duhet të marrë qoftë edhe 100 lekë më shumë, sepse është kryetari i shtetit dhe më pas vijnë të gjitha pagat e tjera.

Nëse ka mundësi Ministria e Financave duhet ta ndryshojë këtë gjë, sepse është organ i specializuar, nuk mund t’i bëjë kushdo pagat. Unë nuk mund të them se do ta vendos unë pagën time, sepse nuk bëhet kështu, nuk ka sens për t’i bërë pagat kështu. Si projektbuxhet ky është në rregull, nuk ka ndonjë problem, por mua më duket absurde vënia e këtyre pagave. A e dini se ku qëndron absurditeti më tepër? Absurditeti qëndron se Gjykata Kushtetuese merr vendime se, pa u bërë vetingu i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, nga data 1 janar atyre do t’u fillojë rritja e rrogës. Pse?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Si do ta marrë rrogën ai që nuk është kontrolluar? Këta duhet të kontrollohen dhe të dalin në rregull, sepse nuk mund t’i japësh rrogën e lartë një gjyqtari apo një prokurori që nuk është kontrolluar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Besoje se Ministria e Financave nuk ka ndonjë gjë për të shtuar lidhur me buxhetin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Më lejoni të sjell në vëmendjen e kolegëve vetëm një fakt, lidhur me akomodimin për dy institucionet e reja, KLD-në dhe KLP-në. Besoj se kjo është një çështje e zgjidhur, sepse të dyja këto institucione të reja të drejtësisë do të kenë një godinë dinjitoze, ku do të sistemohet i gjithë

personeli i nevojshëm, pra anëtarët, stafet administrative dhe gjithë të tjerët. Shumë shpejt do të ketë edhe një vendimmarrje përkatëse lidhur me godinat e reja që të kenë këto dy institucione të rëndësishme. Kështu që edhe nga pikëpamja e ekzekutivit është e zgjidhur kjo gjë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ju lutem, zoti Fino dhe zoti Shameti, a mund ta mbyllim mbledhjen e komisionit apo do të vazhdojmë të debatojmë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ju lutem, sepse është me shumë interes të dihet se ku do të jenë godinat e KLGJ-së dhe KLP-së, sepse është një investim shumë madhor. Fakti se qeveria ka miratuar një fond kontigjence për kompozimin e të gjitha organeve të reja të drejtësisë, që do të ngrihen vitin e ardhshëm, të cilat shkojnë diku te 15 milionë dollarë, tregon seriozitetin dhe vullnetin e kësaj qeverie për të buxhetuar tërësisht jetësimin e zbatimit të plotë të reformës në sistemin e drejtësisë. Në këtë kuadër është edhe akomodimi me godina të reja të KLGJ-ë dhe KLP-së.

Personalisht, si kryetar i komisionit, jam jo vetëm në dijeni, por jam edhe pjesë aktive e grupit të punës për të mbyllur sa më parë akomodimin me godina të reja për këto institucione. Deri më tani është përcaktuar godina. Pritet vendimmarrje për ta ligjëruar edhe nga pikëpamja e vendimmarrjes për akomodimin e këtyre institucioneve, me të gjithë stafet mbështetëse që do të kenë sipas organikës. Kjo besoj se do të jetë një situatë tranzitore normale nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ekzistues në drejtim të organit të ri që do të krijohet.

Shpresojmë që shumë shpejt të përmbillet procesi i vetingut për kandidatët që janë në garë për Këshillin e Lartë Gjyqësor, në mos gaboj është një gjyqtar edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, janë 3 prokurorë që akoma nuk kanë kaluar në sitën e vetingut. Shumë shpejt do të kemi mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve dhe të prokurorëve për të bërë të mundur zgjedhjen e 6 anëtarëve gjyqtarë dhe 6 prokurorëve që do të jenë pjesë e këtyre dy këshillave dhe ne të kemi ngritjen e këtyre dy organeve shumë të rëndësishme të drejtësisë.

Edhe një herë faleminderit për prezencën në komision, edhe për mirëkuptimin e buxhetit të këtij institucioni, relatorit dhe Ministrisë së Financave.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Zoti Haxhiu dëshiron të shtojë diçka, por, nëse e keni për të na falënderuar, na takon neve t'ju falënderojmë për të gjithë punën që bëni në procesin e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për efekt të vetingut.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Me Këshillin e Lartë të Drejtësisë mbyllim seancat dëgjimore për sot, por dhe me të gjitha institucionet që janë përgjegjësi e Komisionit të Ligjeve.

Përpara se ta mbyll mbledhjen, zoti Fino, në cilësinë e relatorit për projektbuxhetin e vitit 2019 ka diçka për të shtuar.

**Bashkim Fino** – Në cilësinë e relatorit, ne bëmë një punë të mirë këto dy ditë duke i trajtuar të gjitha institucionet një e nga një, prandaj dua t’ju falënderoj të gjithëve, sidomos ata që lëviznin më shumë dhe që iknin, të cilët nuk e kuptonin buxhetin.

Unë kam mbajtur shënim të gjitha kërkesat që ju i keni votuar me vullnetin tuaj, të cilat duhet t’ia transmetojmë Komisionit të Ekonomisë, prandaj do të kërkoj nga ju që këto kërkesa të realizohen 100%, sepse janë kërkesa minimale. Pa thënë ndonjë sekret, por edhe zonjat e Ministrisë së Financave që kanë qenë këtu, kanë qenë mirëkuptuese dhe na kanë thënë t’i transmetojmë atje, sepse nga pikëpamja financiare ne jemi të gatshëm që të negociojmë dhe janë dakord.

Nuk jemi futur në diskutimin buxhetit të pushtetit vendor, me një qëllim të caktuar, duke menduar që ai buxhet ka kapur 1% të GDP-së dhe do të vazhdojë ta kapë këtë shifër, ndërkohë që ka një rritje prej 11 milionë lekësh në pushtetin vendor. Nëse do të kishte kritikë, këtë do ta bëja unë për pushtetin vendor, për mënyrën se si janë ndarë fondet. Një pjesë e mirë e fondeve janë ndarë te Fondi i Zhvillimit Shqiptar që unë jam kundër, sepse që kur është krijuar, ai është krijuar për të marrë fonde nga të huajt dhe jo nga buxheti i shtetit. Fondet e rajoneve mund t’i merrnin kryetarët e bashkive ose pushteti lokal dhe nuk kishte përse t’i merrte të gjitha Fondi. Pra Fondit i jepen 5 miliardë buxhet më vete dhe 5 miliardë nga fondi i rajoneve dhe ndërkohë kur flasim për pagat, paga e drejtorit është OJF. Këtë gjë unë nuk e kuptoj dhe kërkoj nga ju si sekretare e përgjithshme e Ministrisë së Financave ta verifikoni me ministrin tuaj, sepse është turp për ne që drejtori i Fondit të Zhvillimit Shqiptar të quhet OJF, duke u mbajtur me lekët e buxhetit të shtetit. Unë u bëj thirrje që të mos miratohet ai nen që ka Fondi i Zhvillimit Shqiptar dhe të marrë 5 milionë e 600 mijë, e barabartë me 5 rrogat e 5 deputetëve. Ku është parë dhe dëgjuar kjo? Nëse është OJF, hiqjani lekët e buxhetit dhe kalojani buxhetin vendor dhe ai le të gjejë fonde nga të huajt.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e kam me rrogën e atij, Spartak, sepse një OJF mund ta ketë sa të dojë rrogën, por jo të financohet nga buxheti i shtetit. Apo e kam gabim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Financimin e merr nga buxheti i shtetit dhe kryen punën e pushtetit vendor. Unë e falënderoj dhe e vlerësoj për punën që ka bërë në të gjitha bashkitë për rrugë, ujësjellës e të tjera me radhë, por ato janë fonde që duhet të trajtohen brenda sistemit të pagave. Nëse ai do të trajtohej brenda sistemit të pagave si një fond që do të merrte nga buxheti i shtetit, nuk do të kishte këtë fond page, nuk do ta kishte më të madhe se ministri dhe jam i bindur për këtë gjë, pra do të kishte një fond page si të gjithë të tjerët. Me një standard të punojmë për pagat dhe me një standard të punojmë me investimet, kjo nuk më duket normale. Po e shpjegoj në komision meqë nuk e trajtuam dhe nuk thirrëm këtu shoqatat, për shkak të kohës së shkurtër që kishim, për të trajtuar pushtetin lokal, sepse, po t'i thërrasësh, ata gjithmonë do të kërkojnë dhe do të tërheqin nga kërraba e tyre.

Të mërkurën tjetër kemi edhe 5 apo 10 minuta kohë, që është miratimi nën për nën i të gjitha kërkesave që unë kam mbajtur shënim dhe që ju i keni miratuar për çdo institucion veç e veç. Të mërkurën do t'ju japim një informacion për çdo institucion ku ne kërkojmë këto shtesa, të cilat do të gërshetohen me Ministrinë e Financave për të gjetur nënin përkatës që të bëhen. Këtë gjë duhet ta kërkojmë edhe në Komisionin e Ekonomisë që ta mbyllim.

Faleminderit, se u zgjata pak!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në këto dy ditë të lodhshme pune të komisionit dua të falënderoj institucionet që iu përgjigjën ftesës sonë për këtë seancë dëgjimore me projektbuxhetin e vitit 2019, ku ishin rreth 19 institucione.

Dua të falënderoj kolegët e mi deputetë, stafin e Komisionit të Ligjeve për impenjimin në diskutimin e projektbuxhetit.

Sigurisht, dua të falënderoj edhe mediat për pasqyrimin e punës dyditore të Komisionit të Ligjeve në lidhje me seancat dëgjimore me projektbuxhetin.

Një falënderim të veçantë e kam për relatorin e projektbuxhetit, kolegun tonë Bashkim Fino, por edhe për dy zonjat e nderuara, sekretaren e përgjithshme të Ministrisë së Financave, zonjën Prodani dhe zonjën Dhëmbi, të cilat si përherë, të paktën sa jam deputet, kanë qenë bashkëpunuese dhe dorëlëshuar në kërkesat që ky komision ka miratuar për institucionet që janë në varësinë e Komisionit të Ligjeve.



Unë bashkohem me sugjerimin e kolegut Fino, që këto që sapo miratuam dhe që do t'i miratojmë edhe nen për nen në mbledhjen e ditës së mërkurë të insistojmë që edhe në Komisionin e Ekonomisë, si komision përgjegjës të merren në konsideratë dhe të votohen në Kuvendin e Shqipërisë.

Të nderuar kolegë, faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**